



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

RAPORTI 6 MUJOR I KOMUNËS SË PRIZRENIT

JANAR-QERSHOR 2019

Synimet dhe prioritetet e kryetarit gjatë qeverisjes:

SHËRBIME EFIKASE

1. Transparencë radikale në prokurim
2. “One Stop Shop” – Modernizim dhe digjitalizim i Qendrës për Shërbim të Qytetarëve.
3. Zvogëlim i numrit të drejtorive.
4. Zgjerimi i ndriçit publik në secilën lagje dhe në secilin fshat, brenda 4 viteve.
5. Ujë për të gjitha lagjet dhe fshatrat e Komunës.
6. Largimi i deponive ilegale dhe intervenim në ujrat e zeza në Landovicë.
7. Pastrimi i shtratit të lumenjve Drini i Bardhë dhe Lumbardhi.
8. Renovimi i Stadiumit të Lirisë.
9. Krijimi i Qendrës së kujdesit ditor për pensionistë dhe transport publik falas për çdo pensionist.
10. Krijimi i punkteve për ushqim dhe veshmbathje për personat në nevojë.
11. Përmirësimi i furnizimit me ujë për të gjitha lagjet dhe fshatrat e Komunës.
12. Ndërtimi i kanalizimit për: Kurrillë, Arbanë, Randobravë, Piranë, Malësi të Vërrinit, Bajram Curr, dhe Nashec.

REGJENERIM URBAN

13. Riorganizimi i trafikut në rrethin e parë unazor dhe në Qendrën Historike.

14. Ridizajnim i konceptit te trafikut urban me qëllim te reduktimit te shfrytëzimit të veturave, për çdo lagje dhe rajon te Komunës, me kosto të perballueshme.
15. Ndërtimi i së paku 300 parkingjeve publike në unazën e brendshme të qytetit
16. Infrastrukturë që u përshtatet personave me nevoja të vecanta.
17. Ndalja e të gjitha ndërtimeve pa leje dhe legalizimi i objekteve pa leje.
18. Kthimi i hapësirave publike tek qytetaret dhe lirimi i trotuareve.
19. Krijimi i me shumë hapësirave të gjelbra dhe rekreative për secilën lagje dhe fshat.
20. Shqyrtimi i hapësirave të reja për funksionalizmin e bibliotekës së re të qytetit.
21. Zgjerimi i hapësirave për arkivën e qytetit.

ARSIM

22. Depolitizimi i sistemit arsimor me transparencë të plotë dhe me participim të komunitetit gjatë zgjedhjes së drejtorëve të shkollave.
23. Katër çerdhe me kosto të përballueshme.
24. Shujtë ushqimore dhe qumësht falas për nxënësit deri në klasën e 5-të.
25. Hapja e laboratorëve të fizikës, kimisë dhe biologjisë, kabinete të muzikës, vizita sistematike mjekësore, inventarizimi me dollapë.
26. Orë plotësuese per nxënës me talente të vecanta dhe orë plotësuese per nxënës që kane ngecje.
27. Organizimi i turnireve sportive per nxënës të shkollave fillore për identifikim te talenteve dhe mbeshtetja e këtyre talentëve nga komuna për të vijuar ne klube sportive.

BUJQËSI

28. Themelimi i tregut lëvizës për prodhimet vendore.
29. Rritje e subvencioneve në bujqësi dhe blegtori.

TRASHËGIMI KULTURORE

30. Funksonalizimi i ndërtesës së shkollës së parë të mesme në trojet shqiptare "Ruzhdije."
31. Themelimi i Këshillit për "Prizrenin në UNESCO" - me synim përmbushjen e kritereve për aplikimin e suksesshëm.
32. Implementimi i planit të menaxhimit për Qendrën Historike të Prizrenit.
33. Inicimi i rregullimit të çështjes pronësore për kinemanë "Lumëbardhi".
34. Fasadimi i shtëpive në Qendrën Historike të Prizrenit.
35. Sinjalizim nëpër rrugë i monumenteve të rëndësishme dhe hoteleve.
36. Ndriçimi i objekteve të trashëgimisë kulturore.

TURIZËM DHE ZHVILLIM

37. Hartimi dhe publikimi i hartave turistike dhe kalendarit turistik.
38. Studim i fizibilitetit për potencialin turistik të Prizrenit.
39. Brendimi i Prizrenit si vend turistik.
40. Programi për zhvillim ekonomik: konsulencë për investimet e Diasporës, konsulencë për zhvillimin e biznes planeve, për aplikimin në grante ndërkombëtare, bashkëfinancim deri 10% për grante ndërkombëtare, subvencionimi i pjesëmarrjes të bizneseve në panairë ndërkombëtare.
41. Funkcionalizimi i parkut të biznesit, në pronat e komunës.
42. Hapja e Qendrës për ndërmarrësi dhe inovacion.

SHËNDETËSI

43. Riorganizimi dhe funksionalizimi i QKMF, pajisja me mjete, laboratore funksionale, dhe trajnim i personelit mjekësor
44. Krijimi i shërbimit të rregullta mbobile shëndetësore - pantronazhit (së paku dy vetura)

Aktivitetet e rëndësishme

Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka së bashku me drejtorët e Drejtorive dhe zyrtarët komunalë gjatë 6 muajve të parë të vitit 2019 ka vazhduar punën dhe angazhimin maksimal në drejtim të përmbushjes së zotimeve dhe ofrimit të shërbimeve sa më efikase për qytetarët. Gjatë kësaj periudhe në këtë drejtim:

- Janë mbajtur takime të shumta, mes tyre me ambasadorin Zviceran në Kosovë, z. Jean-Hubert Lebert, me ambasadorin britanez, z. Ruairí O'Connell, ambasadorin e Republikës së Turqisë në Prishtinë, z. Çağrı Sakar, ambasadorin e Republikës së Çekë në Prishtinë, Pavel Bilek, me përfaqësuesin e OSCE-së në Kosovë, Motoky Hayakawa, shefin e misionit të UNHCR-së në Kosovë, z. Erol Arduç, delegacionin e Batalionit Atlantiku, të përbërë nga ish-vullnetarët e Batalionit, anëtarët e fondit "Vendlindja Thërret" për SHBA dhe Kanada, si dhe veprimtarët e respektuar të komunitetit shqiptar në SHBA, delegacionin e arbëreshëve nga Italia, delegacionin amerikan të Lutjeve të Mëngjesit, të kryesuar nga kongresisti Randy Hultgren, si dhe me përfaqësues të shoqatave të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, me investitorë aktualë e të mundshëm, afaristë dhe qytetarë.
- Janë marrë gjithsej 280 vendime nga Kryetari (për propozimet e drejtorive, formimet e komisioneve, shpallje të thirrjeve publike etj., të cilat mund të gjenden në web faqen e Komunës së Prizrenit)
- Janë mbajtur 15 debate a po dëgjime publike (9 prej tyre për Kornizën Afatmesme Buxhetore, 4 për formimin e rregulloreve të ndryshme si për Kategorizimin e Klubeve Sportive, për Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit, Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Orarin e Punës, Sheshin e Bazhdarhanes si dhe një për segmentin e autostradës Istog – Pejë – Deçan – Gjakovë – Prizren).
- Janë nënshkruar gjithsej 40 marrëveshje (prej tyre 24 me ministri, 15 me OJQ ndërkombëtare dhe vendore dhe një në bashkëpunim ministri-OJQ). Këto marrëveshje do të shërbejnë për ofrimin e shërbimeve efikase, për regjenerim urban, promovimin e gjithpërfshirjes sociale, formimin e rrjeteve profesionale me të rinj,

mbështetjen e tyre në zhvillimin e shkathtësive profesionale, ruajtjen e zëjës së filigranit, për integrimin e komunitetit RAE, të të riadhesuarve.

- Në marrëveshjen e nënshkruar me organizatën gjermane Help është synuar që të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e punësimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Nga kjo marrëveshje kanë përfituar grante 45 biznese nga Komuna e Prizrenit, të cilët janë mbështetur me donacion për pajisje në vlerë mesatare prej 2,000 euro, si dhe me organizimin e trajnimeve profesionale për biznes. Për këtë projekt Komuna e Prizrenit ka kontribuar me 24 mijë euro, kurse Help'i me rreth 80 mijë euro.
- Me marrëveshjen e nënshkruar me ministrinë e Administratës Publike për fillimin e projektit për një qendër të vetme të shërbimeve (One Stop Shop), synohet realizimi i një reforme në rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike për qytetarë. Punimet për këtë projekt do të fillojnë pas mesit të muajit gusht, pasi që të përfundojë fluksi i vizitave të diasporës në mënyrë që ata të mos hasin në vështirësi në pranimin e shërbimeve, ndërkaq me një punë efikase planifikohet që punimet të përfundojnë deri në fund të këtij viti, në mënyrë që viti 2020 të gjejë Komunën e Prizrenit me një ambient modern e të digjitalizuar të qendrës për shërbim të qytetarëve. Në këtë qendër do të ofrohen të gjitha shërbimet, duke filluar nga certifikatat, e deri tek aplikimi për leje ndërtimore, apo procedurat tjera më të komplikuar. Kjo do të thotë se qytetarët nuk do të kenë nevojë që të enden zyreve të komunës lartë e poshtë, por të gjitha shërbimet do t'i kryejnë në një vend dhe në kohë shumë më të shpejtë. Prizreni është komuna e parë në Kosovë që do të ketë një qendër të tillë me shërbime për qytetarë.
- Me marrëveshjen e nënshkruar me nënkryetarin e Komunës Metropolitane të Parisit, Christophe Girard, dhe përfaqësuesen nga Aleanca Franceze e Prishtinës, Anne-Sophie Veyrier, në Prizren do të organizohet një aktivitet ndërkombëtar kulturor "Nuit Blanche 2019", që do të jetë edhe e përkrahur nga Ambasada Franceze. "Nuit Blanche" apo ndryshe "Nata e Bardhë", do të jetë një festival i cili do të mbahet në natën e 31 gushtit në Prizren. Prizreni me këtë rast bëhet qyteti i parë në Ballkan, që është futur në hartën e 30 qyteteve anembanë botës ku organizohet kjo ngjarje, duke iu bashkangjitur qyteteve si Parisi, Kyoto, Brukseli, Miami, Montreal, Toronto, Tel-Aviv etj.
- Me anë të nënshkrimit të kontratës me Caritas Kosova për shërbime të reja shëndetësore për qytetarët, Komuna e Prizrenit do të ketë një numër të mjaftueshëm të personelit mjekësor për të ofruar shërbime shëndetësore me anë të vizitave shtëpiake. Projekti parasheh realizimin e rreth 9,500 vizita shtëpiake dhe ofrimin e mbi 70,000 shërbimeve shëndetësore, për personat që janë në gjende të rëndë shëndetësore dhe kanë vështirësi që t'i vizitojnë qendrat shëndetësore.
- Me marrëveshjen e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit, Komuna e Prizrenit u financua për ndërtimin e rrugës në fshatin Zym dhe ndërtimin e rrugës Planejë-Pashtrik, si dhe u nda një buxhet i caktuar edhe për projektet për asfaltim të rrugës Lubizhdë-Skorobishtë dhe Prizren-Velezhë.
- Me marrëveshjen e nënshkruar me OJQ-në Ec Ma Ndryshe do të krijohen 5 hapësira të gjelbra publike brenda qytetit, përkatësisht në lagjet Bazhdarhane, Dardania, Ortakoll dhe dy në lagje në Lakuriq.
- Me marrëveshjen e nënshkruar me jetimat e Ballkanit do të bëhet ndërtimi i 30 shtëpive për familjet nevojtarë, sipas formës çelësa në dorë. Përveç kësaj marrëveshjeje, Komuna e Prizrenit këtë vit me të hyrat komunale do t'i ndërtojë edhe 30 shtëpi të tjera, ndërkaq do të renovojë edhe 30 shtëpi dhe 30 kulme, duke bërë kështu zgjidhjen e problemit të banimit për së paku 120 familje nevojtare.
- Me marrëveshjen e nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është siguruar një pjesë e mjeteve të nevojshme financiare për ndërtimin e ujësjellësit në Gjonaj, projekt ky me të cilin do të mundësohet furnizimi me ujë i fshatrave të rajonit të Hasit.
- Me marrëveshjet e nënshkruara me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për 10 projekte të ndryshme do të bëhet vazhdimi i atyre që kanë filluar vitin e kaluar si dhe fillimi i projekteve të reja të cilët do të realizohen në Komunën e Prizrenit. Këto memorandume bashkëpunimi përfshijnë realizimin e projekteve për ndërtimin e Qendrave Kulturore në Novo Selo, Pouskë dhe Skorobisht, Fushën Sportive në Lubinjë të Epërme, Poligonin Sportiv në Mushnikovë, Stadiumin e fshatit Gjonaj, Ndërtimin e Stadiumit në Zhur, Ndërtimin e Pishinës Olimpikë, si dhe Kompleksin Sportiv 11 Marsi dhe Stadiumin Përparim Thaqi, ku këto dy të fundit

pritet të përfundojnë së shpejti. Shuma e përgjithshme e këtyre projekteve arrin në më shumë se 3,5 milionë euro.

- Në muajin mars është organizuar panairi i Prodhimeve Vendore. Ky panair është organizuar në veçanti për bizneset e grave nga mbarë Kosova, me qëllim të fuqizimit të gruas dhe ndikimit të saj në shoqëri.
- Në muajin mars në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Zyren Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në Qendrën Sportive “Sezai Surroi” u organizua Panairi i Punës. Ky panair bashkoi rreth 50 bizneseve me punëkërkesit, që të kemi sa më shumë vende pune dhe mos të kemi njerëz që shkojnë jashtë Kosovës për të kërkuar punë.
- Në muajin prill është filluar aksioni “Pastro Qytetin Tënd” në kuadër të javës Ekologjike në Prizren, me ç’rast u organizuan aktivitete të shumta të pastrimit të qytetit në të gjitha vendet ku ka deponi ilegale.
- Në muajin prill Komuna e Prizrenit organizoi një konferencë për “Adaptimin e komunave në ndryshimet klimatike”, në të cilën morën pjesë kryetarët dhe përfaqësuesit e komunave të Mamushës, Junikut, Gjakovës, Deçanit, Suharekës, Malishevës, Rahovecit, Dragashit, Klinës e Mitrovicës, si dhe përfaqësuesit nga organizatat vendore dhe ndërkombëtare.
- Në muajin prill është bërë lansimi i produkteve të reja në fushën e turizmit, përkatësisht të kajakut dhe të biçikletave malore, të cilët do të pasurojnë ofertën turistike në Komunën e Prizrenit. Ky projekt është realizuar në bashkëpunim me organizatën zvicerane Swisscontact dhe projektin PPSE, si dhe operatorin turistik Supercampers, ndërkaq qytetarët dhe turistët këto sporte rekreative mund t’i gjejnë në luginën e lumit të Drinit në fshatin Nashec.
- Në muajin prill u përuaruan punimet e përfunduara në terrenet e hapura sportive pranë Qendrës Sportive "Sezai Surroi", ku qytetarët dhe klubet e ndryshme sportive mund të merren me futboll, basketboll, volejball e hendboll. Pranë Qendrës Sportive, e po ashtu edhe në Marash, në ambient të hapur, janë vendosur pajisjet e reja për ushtrime fizike, të cilat janë të përshtatshme edhe për personat me aftësi të kufizuara.
- Në muajin maj qyteti i Prizrenit është përzgjedhur si "qytet kampion" për realizimin e projektit Greenback 2.0 në kuadër të Programit të Remitancave dhe Pagesave, që implementohet nga Banka Botërore në partneritet me Bankën Qendrore të Kosovës. Ky projekt ka rëndësi të madhe lehtësuese në dërgimin e parave nga migrantëve për familjet dhe miqtë e tyre. Ky projekt ka për qëllim të shërbejë si një mjet për rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të pagesave, duke u përqëndruar specifikisht te remitancat ndërkombëtare. Një projekt i tillë është implementuar nga Banka Botërore në qytete të përzgjedhura nga shtetet si Italia, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Malajzia dhe Shqipëria, ndërsa Prizreni është përzgjedhur si qyteti i vetëm në Kosovë për implementim të këtij projekti
- Në muajin maj u përuarua Parku dhe Këndi i Lojërave për Fëmijë në lagjen Bazhdarhane, duke shtuar kështu një hapësirë mjaft rekreative për qytetarë. Deri në fund të këtij viti Komuna e Prizrenit do t’i ketë 10 parqe të tilla.
- Komuna e Prizrenit ka mbështetur projektin për revitalizimin e rrugës "Marin Barleti", i cili do t’i shtojë vlerë trashëgimisë së pasur kulturore të qytetit të Prizrenit. Me përfundimin e punimeve për revitalizim, ku do të renovohen 14 objekte të ndryshme të kësaj rruge, "Marin Barleti" do të shndërrohet në arterien kryesore të qytetit për nga aspekti i trashëgimisë.
- Punimet e projektit për ndërtimin e impiantit të ujërva të zeza në Vlashnje kanë arritur në fazën përfundimtare dhe së shpejti pritet funksionalizimi i tij. Kjo është hera e parë që një impiant me përmasa të tilla ndërtohet në Kosovë, pasi që kapaciteti i tij mund të arrijë të mbulojë deri në 140 mijë banorë. Falë këtij projekti, do të parandalohet në masë të madhe derdhja e ujërave të zeza në lumin e Lumbardhit.
- Vazhdojnë punimet për ndërtimin e kanalizimit fekal në fshatin Zym të Hasit. Ky kanalizim do të ketë një gjatësi prej 4657 metrave dhe do t’i jep fund një problemi që ka qenë gjithmonë ekzistues në këtë fshat. Pas përfundimit të punimeve për kanalizim, do të fillojnë edhe punimet për rregullimin e infrastrukturës rrugore në këtë fshat.
- Me aktivitete të ndryshme përkujtimore, kulturo-artistike e sportive u shënuan Festat e Qershorit
- Në muajin qershor u organizua konferenca “Për zhvillim të qëndrueshëm në Rajonin e Zhupës - Kundër Hidrocentraleve”, me ç’rast të gjithë pjesëmarrësit, panelistët nga institucionet vendore e organizatat


ndërkombëtare, deputetët, drejtorët, asamblistët, si dhe përfaqësuesit e fshatrave të rajonit e të OJQ-ve nënshkruan një deklaratë të përbashkët nëpërmjet të së cilës nga organet kompetente u kërkua anulimi ndërtimit të hidrocentraleve në Rajonin e Zhupës.

Komunikimi me qytetarë dhe adresimi i kërkesave


Qendra e Thirrjeve- ALO KOMUNA:

Komuna çdo ditë po njoftohet me problemet dhe shqetësimet e qytetarëve, duke pranuar thirrjet nga Qendra e Thirrjeve në numrin pa pagesë **0800 19 200**, si dhe nëpërmjet aplikacioneve mobile *Viber* dhe *WhatsApp* tek numri **+383 45 119 200**, ku qytetarët kanë mundësi që të dërgojnë edhe fotografi për të qenë më qartë në lidhje me rastin, dhe më pas shqyrtohet mundësia për përmirësimin e gjendjes, pasi të adresohet rasti në drejtorinë përkatëse. Çdo ditë, pas përfundimit të orarit, drejtoritë dhe zyra e kryetarit njoftohen nëpërmjet e-mailit për raportimet e pranuar gjatë ditës, ndërsa varësisht nga rëndësia dhe emergjenca, ka raste edhe kur drejtoritë lajmërohen në momentin e pranimin të njoftimit. Qendra e Thirrjeve është duke funksionuar me dy stacione të punës, me orar nga ora **08:00** deri **00:00** dhe në çdo ditë, përfshirë këtu edhe ditët e fundjavës dhe pushimet.

Më poshtë mund t'i gjeni grafikonet për punën dhe funksionimin e Qendrës së Thirrjeve nga data **03.01.2019** deri në datën **30.06.2019**.



Rastet sipas drejtorive



#	Drejtoria	Gjithsej
1	Shërbimet Publike	1011
2	Shëndetësia	9
3	Bujqësia	55
4	Administrata	8
5	Inspektoriati	314
6	Kadastri	1
7	Arsimi	4
8	Mirëqenia Sociale	0
9	Urbanizmi	1
10	Emergjenca	12
11	Kulturë, Rini dhe Sport	0
12	Turizmi	0
13	Ekonomi dhe Financa	4



Numri më i madh i rasteve të lajmëruara nga qytetarët, ka të bëjë me problemet në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Qendra e thirrjeve për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 ka pranuar dhe ka adresuar gjithsej **1419, 1011** prej tyre (**71%**) kanë të bëjnë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ndërsa një numër i konsiderueshëm i lajmërimeve i është adresuar Drejtorisë së Inspektoriatit (**22%**).

Platforma Ndreqe.


ndreqe është platformë online që mbledhë ankesat e qytetarëve për shërbime publike komunale dhe i portretizon në një hartë interaktive. Platforma u mundëson qytetarëve të raportojnë lehtë dhe shpejt ankesat, ndërsa institucioneve komunale iu mundëson kanalizimin e këtyre kërkesave në një vend lehtë dhe të qasshëm. Aktualisht, përmes Platformës **ndreqe** mund të raportohen këto kategori të problemeve: mbeturina, ujëra të zeza, gropa në rrugë, ndriçim publik, trotuar i dëmtuar, shenja të rrugës dhe pengesa për persona me aftësi të kufizuara.

Më poshtë mund t'i gjeni grafikonet për punën e platformës ndreqe nga data **01.01.2019** deri në datën **30.06.2019**.



Bashkëpunimi reciprok ndërmjet *ndreqe* dhe Komunës së Prizrenit ka rezultuar i suksesshëm në shumicën e rasteve. Duke pasur prioritet nevojat e qytetarit si dhe transparencën në qeverisje, Komuna e Prizrenit ka intervenuar në një numër të konsiderueshëm të ankesave.

Grafiku në vijim tregon efikasitetin e Komunës së Prizrenit në rregullimin e ankesave.



Duke e ditur se punimet për kërkesa të ndryshme mund të zgjasin më shumë, Komuna e Prizrenit është duke vazhduar për përmbushjen e këtyre kërkesave edhe në vijim. Po ashtu përveç rasteve të pranuar gjatë këtij gjashtëmuaji, Komuna e Prizrenit në këtë periudhë ka rregulluar edhe raportime të pranuar gjatë vitit të kaluar. Në gjashtë muajt e parë të vitit 2019, Komuna e Prizrenit ka rregulluar gjithsej **57** raportime, **31** prej të cilave janë pranuar në vitin 2019, ndërsa **26** prej tyre janë pranuar para vitit 2019.

Komuna e Prizrenit mbetet e përkushtuar për të vazhduar bashkëpunimin e ndërsjelltë me qytetarë. Falendërojmë qytetarët dhe i inkurajojmë që në vazhdimësi të raportojnë dhe të bashkëpunojnë me ne.

ZYRET E KRYETARIT

Zyra e Prokurimit:

Që nga 1 janari e deri më 31.06.2019 Zyra e Prokurimit ka inicuar gjithsej 111 procedura të Prokurimit për tendere të vlerave të ndryshme, duke filluar nga:

- Procedurat me kuotim të çmimeve
- Procedura me vlera të mesme
- Procedura me vlera të mëdha
- Konkurse Projektimi

Nga numri i përgjithshëm i këtyre procedurave, janë përmbyllur me kontratë gjithsej

- 7 aneks kontrata
- 43 kontrata të rregullta.

Pjesa e mbetur prej 61 projekteve janë në fazën e tenderimit ose të vlerësimit pas hapjes.

- Vlera e përgjithshme e kontratave të rregullta është 2.458.761 euro
- Vlera e përgjithshme e aneks kontratave është 133.018 euro.

Zyra e Personelit

Objektivat e 6 mujorit të parë të kësaj zyreje:

- Hartimi i politikave të personelit dhe menaxhimi i procedurave të shërbimit civil;
- Rekrutimi i nëpunësve civilë në kuadër të Komunës;
- Planifikimi dhe koordinimi i trajnimeve për nëpunësit civilë të komunës;
- Procesi i Vlerësimit Vjetor të personelit në shërbimin civil të Komunës;
- Komunikimi dhe mbështetja brenda institucionit si dhe përfaqësimi i Komunës në organet tjera;
- Harmonizimi i pozitave në shërbimin civil në bazë të katalogut të Vendeve të Punës.

Zyra e Personelit nga data 01.01.2019 deri më datën 30.06.2019 ka pranuar 713 kërkesa në formë fizike dhe 460 kërkesa në formë elektronike, të cilat janë shqyrtuar.

Gjatë kësaj periudhe Zyra e Personelit ka bërë:

- 13 shpallje të konkurseve, 4 rishpallje, 3 zgjatje të afatit, 5 anulime dhe 6 njoftime për përzgjedhje.
- 5 konkurse për shërbime të veçanta dhe punë specifike për kohë të caktuar (të gjitha procedurat që nga propozimi për formim të komisionit deri tek njoftimi i kandidatëve)

Ka pranuar:

- 12 ankesa dhe 1 monitorim të procedurës së rekrutimit për pozitë drejtuese (të cilëve me procesverbal ia ka përgatitur të gjithë lëndët për të cilat është bërë ankesa) dhe
- 13 ankesa në komisionin për ankesa (të cilët i mbështet me dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet)

Zyra për Integritet Evropian

Objektivat/detyrat e punës dhe aktivitetet që janë zhvilluar gjatë periudhës Janar – Qershor 2019 në Zyren për Integritet Evropian të Komunës së Prizrenit janë:

1. Sigurimi i implementimit të Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane për veprimet që ndërlihen me komunën dhe raportimi sipas kërkesave të MAPL-së

- Sipas kërkesës së MAPL/së janë mbledhur të gjitha informatat e kërkuara nga secila drejtori në lidhje me zbatimin e obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane .
- Për periudhën raportuese nga MAPL janë kërkuar dy raportime.
- Është bërë përmbledhja e përgjegjeve nga drejtoritë e Komunës së Prizrenit nga matrica dhe dorëzimi në MAPL dhe MIE.
- Pyetjet në këtë pyetësor kishin të bënin me obligimet komunale sipas agjendës evropiane.

2. Raportimi në mënyrë të rregullt tek zyra e kryetarit për aktivitetet e bëra, pas çdo takimi me OJQ, Ministrinë e Integritet Evropian dhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

3. Pjesëmarrja në takime, trajnime, tryeza dhe punëtori të ndryshme:

- Pjesëmarrja në Trajnimin si të aplikohet për Programin Evropa për Qytetarët në thirrjet e vitit 2019. Takim me drejtorin e Kulturës, drejtorin e Administratës dhe NJDNJ dhe njoftimi lidhur me këtë aplikim.
- Takim në Ministrinë e Punëve të Jashtme lidhur me Ditën e Pavarësisë;
- Takim i Kolegjiumit për ZKIE;

- Pjesëmarrja në punëtorinë dy ditore “Klinika projektsh” - MAPL
- Pjesëmarrja në Tryezën e rrumbullakët me temën “Migracioni dhe trendet e zhvillimit të Burimeve Njerëzore” BDGroup;
- Pjesëmarrja në "Forum in Koordinues të OJQ-ve"-OSBE-Komunë;
- Pjesëmarrja në tryezën me temë diskutimi “Dhuna në baza gjinore dhe përgjegjshmëria e komunave në adresimin e nevojave të viktimave të dhunës në baza gjinore” – KDI.
- Pjesëmarrja në trajnimin tre ditor “Projekte socio-ekonomike me përfshirje gjinore dhe qasje bazuar në të drejtat” –DRC,Ambasada Amerikane;
- Çertifikimi për “Leadership dhe Politikat Publike” dhe për “Profesionist/Specialist të Administrimit të Politikave –AUK / R.I.T Kosovo.

4. Në Raportin Individual të Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane, Komisioni Evropian dhe MAPL si rekomandim kërkonin që të hartohet Rregullorja Komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve;

- Zyra Komunale për Integritet Evropiane ia ka propozuar kryetarit të komunës dhe kryesuesit të kuvendit që të merret vendimi për Hartimin e Rregullores Komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe me iniciativën e zyrës për integritet evropiane dhe Njdnj/së, me përkrahjen e kryetarit dhe drejtorit të administratës dhe me mbështetjen dhe punën vullnetare të OJQ Nevo Koncepti është arritur hartimi i kësaj rregulloreje. Për këtë rregullore u organizuan debate publike me Ojq-të, drejtorët e shkollave, e cila pastaj u aprovua edhe në asamble.

5. Anëtare e Komitetit për Auditim të Brendshëm

- Komiteti i ka mbajtur tre takime: dy konsultative dhe një të rregullt;

Anëtare e Komisionit Komunal për Riintegrim

- Shqyrtimi i kërkesave të paraqitura nga ana e ZKK-së
- Verifikimi i çdo kërkesë të personave të riatdhesuar përmes ZKK-së, pastaj rekomandimi në Zyren - Komunale të Gjendjes Civile dhe procedimi në Komisionin Komunal për Riintegrim. Komisioni ka mbajtur dy takime të rregullta;

6. Bashkëpunim me koordinatoren e Prizrenit Green Growth Centre lidhur me aplikimin e rradhës për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë-Maqedoni, sigurimi i të gjitha dokumenteve dhe informatave të cilat duhen për aplikim.

7. Anëtare për shqyrtimin e ankesave të ardhura nga aplikantë, individë dhe subjekte të ndryshëm nga fusha e sportit, kulturës dhe rinisë për ndarje të subvencioneve.

8. Inicimi i binjakëzimit të Komunës së Bodrumit të Republikës së Turqisë me Komunën e Prizrenit.

Zyra për çështje të Pronës

Në periudhën **Janar-Qershor 2019** pranë Sektorit për Çështje Pronësoro-Juridike janë pranuar gjithsejt **942** lëndë, të cilat janë shqyrtuar dhe është vendosur për **831** prej tyre në afatin e paraparë ligjor, të refuzuara janë **70**, ndërsa **41** lëndë janë në procedurë e sipër.

Më poshtë mund të gjenden shënimet rreth lëndëve të pranuar dhe të kryera sipas detyrave të punës dhe procedurat që kryhen pranë Sektorit për Çështje Pronësoro-Juridike, sipas natyrës dhe sistematizimit të punëve :

1. Procedura e shpronësimit të plotë dhe jo të plotë-servituti dhe procedura lidhur me bartjen administrative (kjo procedurë është zhvilluar në emër të Kryetarit të Komunës, në pajtim me Ligjin Nr.03/L-139:

- Lëndë të arritura – 3, të kryera – 2, në procedurë e sipër - 1.
2. Procedura e anulimeve të aktvendimeve të plotfuqishme mbi eksproprijimin:
- Lëndë të arritura - 0, lëndë që janë kryer 0.
3. Procedura lidhur me bartjen e së drejtës së përparësisë së ndërtimit:
- Lëndë të arritura – 151, të kryera – 135, në procedurë - 16.
4. Procedura e zgjidhjes së marrëdhënieve pronëso- juridike lidhur me legalizimin e objekteve të ndërtuara pa lejen e organeve kompetente:
- Lëndë të arritura - 0, të kryera - 0, në procedurë e sipër - 0, të refuzuara - 0.
5. Procedura lidhur me lëshimin e certifikatave mbi vërtetimin e kontratave mbi Shitblerjen pranë organeve Gjyqësore:
- Lëndë të arritura – 361, të kryera - 361.
6. Procedura lidhur me përpilimin e kontratave mbi qiranë për lokalet pronë e KK Prizrenit dhe kontrolli lidhur me përmbushjen e obligimeve që dalin nga to:
- Lëndë të arritura – 189, Kontrata të lidhura -24, Vërejtje - 4, Vërejtje para padisë -14, kërkesa-136, njoftim -5, ekzekutim – 1, Vendim-3 dhe konkluzion mbi ekzekutim - 2.
7. Procedura lidhur me vërtetimin dhe konstatimin e uzurpimit arbitrar të tokës në pronësinë shoqërore:
- Lëndë të arritura dhe të bartura – 31, konkluzione për ndërprerjen e procedurës – 1, njoftime mbi ndërprerjen e procedurës – 1, aktvendime të kryera – 10, lëndët në procedurë e sipër – 19.
8. Kërkesa të ndryshme-njoftime për Gjykatën Komunale, Asamblenë, palëve dhe për Avokatin Publik Komunal, gjithsej - 70 lëndë.
- Prej tyre të kryera (aprovuara) - 15, në procedurë - 0 dhe të refuzuara - 69.
9. Paga e tokës ndërtimore sipas YU Programit (kërkesa të arritura - 0, të kryera - 0)

Puna e Sektorit për Çështje pronëso- juridike është e lidhur(varur) edhe me organet tjera si në kuadër të KK Prizrenit si Avokaturën Publike Komunale, Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorinë e Inspektorateve si dhe me organe jashtë KK Prizrenit - Shërbimin Policor të Kosovës, etj.

Paraqitja tabelore e lëndëve:

Nr.	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të aprovuara	831
		Të refuzuara	70
		Në procedurë	41
	942	Gjithsej	942

Zyra e Përfaqësimit Ligjor

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në Zyrën e Përfaqësimit Ligjor për muajin raportues

- Përfaqësimi i Komunës pranë Gjykatave kompetente në të gjitha nivelet e vendit dhe Prokurorinë e Shtetit;
- Menaxhimi dhe përgatitja në mbrojtje të lëndëve në kuadër të kompetencave ligjore;
- Ushtrimi i mjeteve juridike, ankesa, kërkesa, revizione, mbrojtje të ligjshmërisë, fletëparaqitjeve kur ka të bëjë me abuzimin e detyrave të punës në kuadër të Komunës, korrigjimi i vendimeve, aktgjyqimeve, aktvendimeve, përcjellja e dukurive dhe rrjedhën e punës në kuadër të Komunës dhe atë në të gjithë resorët zyrtarë;
- Kontrollimi i arkivit të zyrës, mirëmbajtja e librave dhe lëndëve, komunikimi me palë ndërgjyqës si dhe raportimi para Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës.
- Procedimi i të gjitha lendeve të ofruara nga ana drejtorive për borgjet dhe përmbarimi i tyre përmes përmbaruesit.
- Përfaqësimi sa më i denjë i Komunës dhe të gjitha subjekteve juridike në kuadër të Komunës, prezantimi dinjitar para gjykatave të vendit dhe sipas nevojës edhe jashtë vendit, mbrojtje juridike të pasurisë dhe pronës së komunës si ideale kryesore, profesionalizmi sa më të lartë të kësaj zyre për t'i dhënë pasqyrë të pastër komunës, autoritet dhe siguri juridike para organeve të tjera shtetërore që sa më profesionale dhe komplete të jetë kjo zyre;
- Përpilimi i parashtrësive, ankesave, padive, përgjigjeve në padi dhe shkresave të tjera të parapara me ligj;
- Bashkëpunimi me të gjitha drejtoritë të tjera për mbrojtjen e interesave institucionale, si dhe të institucioneve që financohen nga Komuna, në procedurën civile, përmbaruese dhe administrative në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet;
- Kryerja e punëve të tjera në bazë të kërkesave të Kryetarit të Komunës.

1. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA Aktivitete e Përgjithshme

Nr.	Shkresat /parashtrës	Janar	Shkur t	Mar s	Prill	Maj	Qersho r	Gjithsejtë
1	Ankesa	31	41	29	22	19	6	148
2	Padi	3	1	1	1	3	2	11
3	Përgjigje në ankesë	/	/	2	/	3	/	5
4	Përgjigje në padi	6	9	1	12	4	5	37
5	Prapësim	16	8	11	8	8	2	53
6	Revizion	1	2	1	/	/	/	4
7	Fjala përfundimtare	12	2	4	2	4	3	27
8	Mbrojtje të ligjshmërisë	2	/	/	/	1	/	3
9	Seanca të mbajtura	42	47	49	52	54	45	289
10	Urdhër përmbarues	9	5	3	7	7	10	41
11	Urgjenca	/	/	/	4	6	/	10
12	Shkresa të ndryshme	43	60	50	60	52	50	315
	Total:	165	175	151	168	161	123	943

2. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda zyrës së përfaqësimit ligjor;
- Përfaqësimi në seanca gjyqësore në baze të ftesave të pranuar nga ana e Gjykatave dhe organeve të tjera;
- Përpilimi i të gjitha shkresave, ankesave, padive, përgjigjeve në padi parashtrësive të nevojshme brenda afatit ligjor;
- Pranimi dhe regjistrimi i ftesave dhe vendimeve nga organet gjyqësore;
- Mbajtja, evidentimi i lëndëve si dhe arkivimi i tyre;
- Daktilografimi i të gjitha shkresave të lëndëve;
- Fotokopjimi i shkresave të lëndës;
- Përcjellja e shkresave dhe akteve në drejtoritë komunale dhe organeve tjera;

- Përpilimi i raporteve periodike për të gjitha punët e kryera në Zyrën e Përfaqësimit Ligjor, etj.

Zyra Ligjore

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në Zyrën e Ligjore

- Sigurimi i shërbimeve juridike dhe këshilluese ligjore për të siguruar menaxhim efektiv të rreziqeve ligjore dhe kontraktuale si dhe hartimi dhe shqyrtimi i legjislacionit sekondar.
- Udhëheqë punën e gjithmbarshme të sektorit dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Menaxhon me stafin e sektorit dhe bënë ndarjen e detyrave tek varësit e tij, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore;
- Shqyrton propozimet e rregulloreve dhe akteve të tjera që i propozohen kuvendit të komunës për miratim;
- Harton rregulloret, urdhëresat administrative si dhe aktet tjera juridike që i lëshon kryetari i komunës;
- Siguron ndihmë juridike, shërbime dhe këshilla ligjore për drejtoritë, zyret dhe sektorët e komunës;
- Siguron që projekt rregulloret, e propozuara dhe të hartuara të jenë në përputhje me standardet e ligjet përkatëse dhe politikat komunale si dhe statutin e komunës;
- Siguron përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesit të komunës dhe institucioneve që financohen nga Komuna në procedurën civile, penale, përmbareuese dhe administrative, në gjykatat e vendit në të gjitha nivelet;
- Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara;

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

3.1 Aktivitete e Përgjithshme

Nr.	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Totali Nr lendes/faqe
1	Procesverbalet e Kuvendit dhe te tjerat	5/94	4/59	3/9	5/57	2/43	4/46	23/308
2	Procesverbalet i KK-së	2/22	2/19	2/51				6/92
3	Procesverbalet për KPF		2/6	1	1	1		5/6
4	Procesverbalet e KKS		2/8					2/8
5	Rekomandimet e KPF-së	2/2	14/12	7	8	1/8		32/22
6	Rekomandimet e KK-së		1/1					1/1
7	Rekomandime për MB	2	2	3		4	5	16
8	Aktvendimet	1/2	6/6	3/3		1/10		11/21
9	Vendime	37/16	147/67	141/70	30/30	91/52	53/18	499/253
10	Konkluzione		1/1	2/7		1/1		4/9
11	Njoftime-Ftesa	7/7	7/7	3/4	1/2		7/7	25/27
12	Raporte	9	6/41	2/10		3/3		20/54

13	Rend Dite	1	4/4	6/4	1/1	14/3	5/2	31/14
14	Rekomandime	9/2	2			8	14/11	33/13
15	Vërtetime	2		2				4
16	Pyetje te anëtareve te kuvendit	19	26	28	32	20	24	149
17	Mbledhje e kuvendit te Komunës	1		1	2	1	1	6
18	Debate publike	2/2	4/7	3/5			3	12/14
19	Aktgjykime	3/5						3/5
20	Kërkesa /Ankesa	6/2	2/2	1/1	1/2		2/2	11/9
21	Planet e Punës	1/3	35/42	4/65	3/49			43/159
22	Pëlqime	1						1
23	Propozime	1		13/2	2	2/6		18/8
24	Përgjigje	2		1/1				3/1
25	Aneks memorandumi	1						1
26	Kërkesa te palëve (ne reception)	500		6000	2000	2000	3000	13500
27	Konkurse		8/9	3/10	1/2		1/6	13/27
28	Statut		9/21	1/7				10/28
29	Dhenia e numrave ne sportel		140					140
30	Realizimi i buxhetit			60/138				60/138
31	Rregullore			1/12	4/27	1		6/39
32	Propozim vendime per kuvend					5/4	1/2	6/6
33	Autorizime					1	1	2
34	Vendimet e Kuvendit					4/7		4/7
35	Përgjigje e intervistave					1/3		1/3
36	Lajme					3/3		3/3
37	Të tjera	1/2	11/12	19/20	3/5	3/1	7/5	44/45

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

- Organizimi dhe koordinimi e punëve brenda sektorit ligjor;
- Përpilimi i të gjitha shkresave, të nevojshme brenda afatit ligjor;
- Mbajtja, evidentimi i lëndëve si dhe arkivimi i tyre;

- Përcjellja e shkresave dhe akteve në drejtoritë komunale dhe organeve tjera;
- Përpilimi i raporteve periodike për të gjitha punët e kryera në Zyrën Ligjor, etj.

Zyra për Komunikim

- Qytetarët e Komunës së Prizrenit, përfaqësuesit e OJQ-ve dhe mediat edhe gjatë këtij 6 mujori janë informuar me kohë dhe saktë për aktivitetet e kryetarit të Komunës, realizimit të projekteve nga drejtoritë komunale dhe punës së kuvendit të komunës.
- Gjatë periudhës janar – qershor 2019, janë publikuar mbi një qind e pesëdhjetë lajme nga aktivitete të ndryshme komunale, të cilat janë përcjellur edhe me fotografi.
- Në mënyrë të vazhdueshme është bërë përditësimi i ueb faqes me informacione të reja.
- Ueb faqja është pasuruar edhe me dokumente të reja, si procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit dhe të KPF-së, video-linqet e mbledhjeve të Kuvendit, lejet ndërtimore, janë shtuar informacionet e drejtorëve e asamblistëve komunalë, janë shtuar telefonat me rëndësi, si dhe është vazhduar me publikimin e raporteve të punës së drejtorive, të draft rregulloreve, shpalljeve publike etj.
- Dhjetëra komunikata dhe njoftime janë publikuar në adresë të mediave, OJQ-ve dhe audiencave publike, lidhur me obligimet e ndërsjella dhe pagesave të afatizuara në kohë.
- Opinionin publik është mbajtur në dijeni për gjithë vendimmarrjen e Komunës.
- Të gjitha vendimet e kryetarit të Komunës janë publikuar në ueb faqe, ndërkaq të gjitha vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës janë publikuar në afat ligjor pas konfirmimit nga MAPL.
- Janë pranuar 21 kërkesa nga OJQ, gazetarë dhe qytetarë, për qasje në dokumente publike. Të gjitha kërkesat janë adresuar në sektorë adekuat për përgjigje.
- Zyra për komunikim me publikun gjatë muajit janar 2019 ka filluar hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë komunale 2019. Ndërkaq pas kërkesës së MAPL-së, për hartim të këtij dokumenti për katër vite, është filluar me hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë të Komunës për vitet 2019-2023. Tani ky dokument është publikuar në ueb faqe dhe është i konfirmuar ligjërisht edhe nga MAPL. <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2018/04/Shqip-Vendim-plani-i-veprimit-per-transparence.pdf>
- Me kërkesë të ndryshimeve ligjore, Komunitat e Republikës së Kosovës obligohen që të plotësojnë-ndryshojnë edhe rregulloret për Transparencë të Komunave. Ndërkaq edhe rregullorja Komunale për transparencë u miratua në seancën e muajit Korrik.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

“Auditimi i brendshëm” është veprimtari e pavarur me siguri objektive dhe këshillëdhënëse, për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës.

Detyrat e Auditimit të Brendshëm:

- Përgatitjen dhe dorëzimin e planit strategjik dhe planit vjetor për rishikim dhe miratim tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe te Komiteti i Auditimit, në ato subjekte ku është i themeluar ky Komitet;
- Organizon, kryen dhe mbikëqyrë ushtrimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit dhe dorëzimin e rezultateve të përgjegjesit e Organizates Buxhetore;
- Bashkërendimin e ndërveprimit me Njësinë Qendrore Harmonizuese dhe me institucionet e auditimit të jashtëm, para dorëzimit të regjistrave apo raporteve palëve të jashtme, drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm merr aprovimin nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik;
- Përgatitjen dhe dërgimin e raporteve gjashtë (6) mujore dhe vjetore te Kryetari i Komunës dhe Njësia Qendrore Harmonizuese në MF.

Detyrat (Auditimet) e realizuara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019:

1. Shpenzimet nga paraja e imët (janë dhënë dy rekomandime);

2. Rregullsitë lidhur me grumbullimin e të hyrave nga taksa për mbeturina (janë dhënë tre rekoamdime);
3. Auditim me kërkesë të Kryetarit: Pajtueshmëria e proceseve për të hyrat dhe shpenzimet në KF , Liria,, në teatrin e qytetit „ Bekim Fehemiu,, si dhe procesi i shpenzimeve në KB „Bashkimi,,(janë dhënë njëmbëdhjetë rekomandime);
4. Rishikimi i ecurisë mbi implementimin e rekomandimeve gjatë auditimeve të dhëna për vitin 2018 nga njësia e auditimit të brendshëm (është dhënë një rekomndim).

DREJTORITË


DREJTORIA PËR EKONOMI DHE FINANCA

Njësia për Financa:

Komuna e Prizrenit për periudhën janar-qershor nga të hyrat vetanake ka inkasuar një shumë prej 3,546,299 € ose 40% sipas planifikimit për vitin 2019 (8,717,394 €).

Të Hyrat e realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë (Janar-Qershor) të vitit 2017 kanë qenë 3,327,088 €, në të njëjtën periudhë (Janar-Qershor) të vitit 2018 të Hyrat vetanake kanë qenë 3,074,202 €. Në vitin 2019 të Hyrat e realizuara për periudhën Janar-Qershor 2019 kanë qenë 3,546,299 € apo 15.35% më shumë se vitin 2018 dhe 6.6% më shumë se vitin 2017.

**Të Hyrat për periudhën JANAR-QERSHOR për tre vite
(2017,2018,2019)**




Shpenzimet e buxhetit të Komunës së Prizrenit për periudhën janar-qershor 2019 kanë qenë 18,008,059€, ose 38% sipas planifikimit për vitin 2019 (47,574, 262€).

Njësia për Tatim në Pronë dhe të Ardhura Tjera:

Tatimi në pronë është taksë vjetore komunale. Të hyrat nga tatimi në pronë shfrytëzohen për zhvillimin e infrastrukturës Komunale. Tatimi në pronë aplikohet për të gjitha kategoritë për pronat e paluajtshme në Komunën e Prizrenit. Vlen të theksohet se të gjitha mjetet financiare të cilat inkasohen nga pagesa e tatimit në pronë, janë të hyra kryesore të cilat mbesin në Buxhetin Komunal dhe shërbejnë për zhvillimin e infrastrukturës, që ndikon drejtpërdrejt në ngritjen e mirëqenjes së qytetarit.

Të Hyrat nga Tatimi në Pronë gjatë periudhës janar-qershor 2017 kanë qenë 1,012,991.06€. Në periudhën e njëjtë kohore (Janar-Qershor) të vitit 2018 të hyrat nga Tatimi në Pronë kanë qenë 1,141,299.98 € apo shprehur në përqindje 12.7% më shumë se në vitin paraprak (2017), ndërsa të hyrat për periudhën Janar-Qershor 2019 kanë qenë 1,270,257.23 apo 11.3% më shumë se në vitin e kaluar (2018), dhe për 25.4% më shumë të hyra të realizuara së në vitin 2017.



Ndërkaq të hyrat nga Taksat Komunale për biznese në periudhën **Janar-Qershor 2019** janë **83.141,36 €** dhe ka një rritje prej **158%** krahasuar me të hyrat për të njëjtën periudhë të vitit **2018** të cilat kanë qenë **32.275.57 €**.

Sektori për Buxhet dhe Thesar

- Është përpiluar plani i cash flow-ut për vitin 2019 sipas drejtorive dhe raporti vjetor i NDF-së.
- Është kryer alokimi dhe është bërë ndarja e mjeteve sipas drejtorive.
- Në bashkëpunim dhe në konsultim me Drejtoritë është bërë bartja e mjeteve nga të Hyrat Vetjake 2018 në vitin 2019 për investime kapitale.
- Në bashkëpunim me zyrën e kontabilitetit është punuar pasqyra financiare për periudhën Janar – Dhjetor 2018.
- Është bërë parashikimi fillestar i të Hyrave Vetanake për vitin 2020-2022.
- KA filluar një analizë e detajzuar të realizimit të pagave për muajin Janar-Qershor 2019 të Administratës Komunale. Kjo analizë do të vazhdojë edhe në muajtë e ardhshëm, qëllimi i së cilës është që planifikimi i Buxhetit Komunal të jetë sa më real dhe i saktë.
- Është proceduar Planifikimi Afatmesëm i Buxhetit për periudhën 2020-2022, duke u referuar në qarkoren buxhetore (2020/1). Është proceduar edhe korniza afatmesme buxhetore Komunale (qarkorja 2020/1).
- Është punuar në zhvillimin dhe publikimin e KAB-it 2020-2022. Përveç kësaj në mënyrë rapide janë shqyrtuar prioritetet e Buxhetit Komunal, duke punuar me drejtorët e Drejtorive në vendosjen e kufijve të brendshëm buxhetor në përputhje me grantin Qeveritar.

- Në muajin qershor 2019 KAB-i u analizua nga strukturat Komunale, dhe më 28.06.2019 u aprovua dhe u dorëzua në MF.
- Është bërë përpunimi i Cash Planit për vitin 2019.
- Është formuar Komisioni për llogari të arkëtueshme për periudhën gjashtëmujore i cili do të merret kryesisht me analizën e të hyrave të arkëtueshme dhe do të përgatitë një raport-plan veprimi për ekzekutimin e të hyrave vetjake.
- Në muajin Mars është bërë hapja e objektit të drejtorisë dhe është përfunduar projekti i modernizimit të sporteve dhe hapësirave. Projekti ka kushtuar 48,825.84 €.

Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave në periudhën Janar – Qershor të vitit 2019 sipas planifikimit të buxhetit ka realizuar:

Kategoria e Shpenzimeve	Planifikimi	Realizimi	Diferenca	Përqindje
Paga	243,958.00 €	120,572.45 €	123,385.55 €	49,42 %
Mallrat dhe Shërbimet	252,150.00 €	72,951.51 €	179,198.49 €	28,93 %
Shpenzimet Komunale	45,273.00	3,037.15 €	42,235.85 €	6,71 %
Investimet Kapitale	328,376.00 €	68,319.84	260,056.16	20.81 %

Qendra Komunale e Biznesit (QKB)

Në muajin mars subjektet afariste janë njoftuar për kërkesën që pronarët e firmave të kryejnë procedurën e ndërrimit të NRB në NUI sipas kërkesës së Qendrës Komunale për Biznes.

Nga ana e QKB-së, për periudhën kohore Janar - Qershor 2019 , janë kryer punët si në vijim:	
Regjistrimi i bizneseve të reja	358
Shuarje të Biznesit	89

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Qëllimet	Objektivat/ Projektet (kodi)	Aktivitetet
	1. Pastrimi dhe largimi i dheut; 2. Largimi i mbeturinave;	➤ Është bërë intervenimi në: Pastrimin e shtratit të Lumit Lumbardhë, ku është bërë gjurmimi dhe ngarkimi i

	<p>3. Ndërtimi i mureve mbrojtëse</p> <p>4. Furnizimi me gypa të ndryshëm</p> <p>Kodi i projektit 4345</p>	<p>mbeturinave, dherave dhe gurëve të cilët kanë pengu rrjedhën e lumit, po ashtu është bërë edhe prerja dhe largimi i drunjve të cilët kanë pengu rrjedhën e ujit të lumit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Punimi i murit mbrojtës te varrezat e qytetit dhe muri mbrojtës në fshatin Landovicë. ➤ Intervenimi në pastrimin e deponive ilegale dhe të rrezikshme.
<p>Përmirësimi i gjendjes infrastruktururore në ato rrugë që janë të ndërtuara me kubëza betoni , si dhe rregullimi i trotuareve</p>	<p>1. Mirëmbajta dhe rregullimi i rrugëve që janë të ndërtuara me elemente betoni .</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ “Rehabilitimi i rrugës Agron Bytyqi” – te Qylhani; ➤ Rehabilitimi i rrugës Mehmet Pasha; ➤ Rehabilitimi i rrugës Justiniani – lagja jeta e Re; ➤ Rehabilitimi i rrugës Mehmet hasi – te varrezat e Qytetit; ➤ Rehabilitimi i rrugës Flamuri – te QMF 11 Marsi; ➤ Rehabilitimi i gropës te rruga Flamuri; ➤ Rr. Shen Jeronimi- renovimi i rruges me gur graniti; ➤ Rr. Gustav Majer- ndërtimi i hapësirave mes banesave; ➤ Zhur- rruga tek Stacioni Policore, ndertimi i rruges; ➤ Justiniani- renovimi i rruges; ➤ Rr. Ali Pashe Tepelena-anesore, renovimi i rruges; ➤ Rr. Lubizhde; ➤ Pirane- rruga 2- ndertimi i rruges; ➤ Rr Agron Bytyqi- renovimi i rruges; ➤ Rr. Vatrart Shqiptare- renovimi i pllakave tek Ura e Arastes; ➤ Oborri i Shtepise se Bardhe- ndertimi i stazes; ➤ Rruga anesore tek Transiti i vjeter; ➤ Rr. Qene Qenaj- renovimi i rruges ne lagjen Jeta e Re; ➤ Varrezat e Martireve – Tusuz; ➤ Rambuje – pjesa kah ABI Center; ➤ Rruga ne fshatin Landovice; ➤ Rruga Jusuf Gervalla – anesore ➤ Rruga Xhevat Berisha – anesore; ➤ Rr. Tefik Qanga; ➤ Rruga “Kurila”; ➤ Varrezat e Martireve – Tusuz;

		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rambuje – pjesa kah ABI Center; ➤ Rruga ne fshatin Landovice; ➤ Rruga Jusuf Gervalla – anesore ➤ Rruga Xhevat Berisha – anesore; ➤ Rr. Tefik Qanga; ➤ Rruga “Kurila”;
	<p>2. shtimi i trotuareve të reja në qytet dhe fshatra Kodi i projektit 82447</p>	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndertimi i trotuarit te varrezat ne fshatin Zhur; ➤ Ndertimi i trotuarit ne rrugen Trepça - Ortakoll; ➤ Rr. Ismail Kryeziu- anesore, rregullimi i trotuarit; ➤ Rr. Jusuf Gervalla- trotuaret, montimi i mbulojave te pusetave; ➤ Rr. Papa Gjon Pali II- rregullimi i trotuarit tek Xhamia ➤ Rr. Indrit Cara Kavaja- rregullimi i anesoreve 18/24cm ne trotuar; ➤ Rr. Ali Hadri- ndertimi i trotuarit; ➤ Rr. Wesley Clark- renovimi i trotuarit para Furres Trosha ne Ortakoll; ➤ Rr. Indrit Cara-Kavaja, ndertimi i trotuareve; ➤ Rr. Gjeravica- renovimi i trotuarit tek parku i vogel ,afër QKMF- Ortakoll; ➤ Fshati Korishe – ndertimi I trotuareve; ➤ Ortakoll – ndertimi I trotuareve tek banesat kolektive; ➤ Rr. Turgut Ozal- ndertimi i trotuareve ➤ Rr. Rust Kabashi – ndërtimi I trotuareve ➤ Atmaxhe- ndertimi i trotuareve; ➤ Fshati Korishe – ndertimi I trotuareve; ➤ Ortakoll – ndertimi I trotuareve tek banesat kolektive; ➤ Rr. Turgut Ozal- ndertimi i trotuareve ➤ Rr. Rust Kabashi – ndërtimi I trotuareve ➤ Atmaxhe- ndertimi i trotuareve;
<p>Përmirësimi i gjendjes infrastrukturore në ato rrugë që janë të me asfalt si dhe rindërtimi i rrugëve me asfalt</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mirëmbajta dhe adaptimi i rrugëve që janë të ndërtuara me asfalt . 2. Shtresimi i rrugëve të reja 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Është bërë Adaptimi i gropave me asfalt te të ftoftë nëpër rrugët e qytetit ; ➤ Është bërë rregullimi dhe nivelizimi i trasesë, në rrugën “Indrit Cara”. ➤ Është bërë furnizimi, transporti dhe shtruarja me asfalt e rrugës “Indrit Cara”.

<p>Përmirësimi i gjendjes infrastrukturore ujore, riparimi i kanalizimeve , ujësjellësve si dhe rregullimi i kapakëve në Komunë e Prizrenit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mirëmbajtja dhe riparimi i kanalizimeve në Komunë tonë 2. Mirëmbajtja dhe riparimi i sistemit të ujësjellësit 3. Rregullimi i kapakëve 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Rehabilitimi i kanalizimit ne Korishe; ➤ Rehabilitimi i kanalizimit ne rrugen Brigada 128 – lagjja Bajram Curri; Rehabilitimi i pusetës te rruga Rogova; ➤ Rehabilitimi i kanalit te xhamia Pavarsia – lagjja Bajram Curri; ➤ Rehabilitimi i kanalit ne Kabash te Hasit; ➤ Rehabilitimi i kanalit ne fshatin Korishe; ➤ Rehabilitimi i kanalit ne rrugën Ali Pashe Tepelena; Rehabilitimi i kanalit ne rrugën Sali Bytyqi; ➤ Kanalizimi ne rrugën Sali Bytyqi – Lagjja Bajram Curri; ➤ Rruga Halil Berisha-te Gjumnazi; ➤ Rruga Besnik Muqaj; ➤ Kanali Gernqare; ➤ Kanalizimi atmosferik dhe fekal ne lagjen Jeta e Re – rruga Dervish Salihu; ➤ Kanalizimi atmosferik – Korishe Lagjja Duhit; ➤ Riparimi i kanalit te rruga Agron Bytyqi; ➤ Ujsjellesi Bylbyldere; ➤ Ujsjellesi ne Gjonaj; ➤ Rregullimi i pusetave ne lagjen Ortakoll; ➤ Leshesa te banesat sociale – debllokimi; ➤ Ujmbledhesi ne rrugen Sanxhaku; Punimi i kapakeve dhe ujembledhesave ne lagjen e UÇK ne Tusuz
<p>Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për rrugët e pashtruara</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Furnizimi me zhavorr për rrugët e paasfaltuara 	
<p>Vendosja e ndriçimit publik nëpër rrugët e reja si dhe përmirësimi i gjendjes ekzistues të ndriçimit</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Riparimi i ndriçimit ekzistues 2. Rregullimi i semaforëve ekzistues 3. Ngritja e efiqencës në ndriçimin publik 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Mirëmbajtja e ndriçimit publik në tërë komunën ➤ Riinstalimi i disa llambave LED në disa vende në territor të komunës ➤ Instalimi i 70 llambave LED 40Ë të ndriçimit publik në fshatin Randobravë dhe instalimi i kabllit ajror në gjatësi prej 3000m ➤ Vendosja e 46 shtyllave të ndriçimit publik dhe instalimi i 46 llambave LED 60Ë në fshatin Piranë

		<ul style="list-style-type: none"> ➤ Riinstalimi komplet i ndriçimit publik me 81 llamba LED 80Ë në: rr. “Ismail Kryeziu” dhe 32 llambave LED 80Ë në rrugën “Ukë Bytyçi” ➤ Instalimi i 11 llambave LED 40Ë të ndriçimit publik në fshatin Lubizhdë dhe instalimi i kabllit ajror në gjatësi prej 450m ➤ Gërmimi i kanalit gjatësor 135m në rrugën “Hajdar Maloku” dhe vendosja e 159m gyp fleksibil $\Phi=63\text{mm}$, shiritit të tokëzimit në gjatësi 144m dhe shiritit për vërejtje në gjatësi 135m ➤ Gërmimi i kanalit gjatësor 110m në rrugën “Mevlan Hoxhaj(Azem Bejta)” dhe vendosja e 135m gyp fleksibil $\Phi=63\text{mm}$, shiritit të tokëzimit në gjatësi 120m dhe shiritit për vërejtje në gjatësi 110m ➤ Gërmimi i kanalit gjatësor 100m në rrugën “Dëshmorët e Prekazit” dhe vendosja e 120m gyp fleksibil $\Phi=63\text{mm}$, shiritit të tokëzimit në gjatësi 110m dhe shiritit për vërejtje në gjatësi 100m ➤ Gërmimi i kanalit gjatësor 175m në rrugën “Fan Noli” dhe vendosja e 210m gyp fleksibil $\Phi=63\text{mm}$, shiritit të tokëzimit në gjatësi 190m dhe shiritit për vërejtje në gjatësi 175m ➤ Gërmimi i kanalit gjatësor 180m në rrugën “Gafurr Xhaferi” dhe vendosja e 215m gyp fleksibil $\Phi=63\text{mm}$, shiritit të tokëzimit në gjatësi 195m dhe shiritit për vërejtje në gjatësi 180m ➤
<p>Shtimi i kapacitetit të ujit të pijes nëpërmjet investimeve konkrete në ndërrimin e tubacioneve dhe ndërtimin të rezervuarve</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shtimi i ujit të pijes 24 orë në ditë ; 2. Ndërrimi i tubacioneve ; 3. Ndërtimi i rezervuarit ; 4. Sani i humbjeve të ujit ; 5. Kycja e fshatrave në sistemin e menaxhimit 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërtimi i infrastrukturës në rrugën Fahredin Hoti rrjeti i ujësjesit”.
<p>Përmirësimi i infrastrukturës rrugore</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndërtimi i rrugëve të reja në qytet dhe fshatra 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërtimi i infrastrukturës rrugore ne lagjen Bajram Curri Rregullimi i infrastrukturës në deponin e mbetjeve inerte në fshatin Zhur; ➤ Rregullimi i infrastrukturës në deponin e mbetjeve inerte në fshatin Zhur

		<p>Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Vlashne;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërtimi I infrastruktures rrugore ne fshatrat e Lumbardhit dhe Podgurit; ➤ Ndërtimi I rrugëve lokale në fshatin Trepeticë të Prizrenit; ➤ Shtruarja e rrugëve me kubza në Lubizhdë të Prizrenit; ➤ Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Zojz të Prizrenit’’ ➤ “Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Trepeticë të Prizrenit ➤ Ndërtimi i infrastruktures rrugore në fshatin Gjonaj ➤ Shtruarja e rrugëve me kubëza në Lubizhdë të Prizrenit ➤ Ndërtimi i kanalizimit fushorë në fshatin Krushë e Vogël ➤ Ndërtimi i infrastruktures rrugore në Arbanë ➤ Ndërtimi i infrastruktures rrugore në Caparc
<p>Ngritja e nivelit të infrastruktures komunale ,</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përmirësimi i rrjetit të kanalizimit nëpër vendbanime të ndryshme ; 2. Shkarkimi i rrjetit ekzistues 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Ndërtimi i kanalizimit ne fshatin Zym; ➤ Ndërtimi i kanalizimit ne fshatin Kushnin –Lagjja Murselaj ➤ Ndërtimi i kanalizimit dhe rrugicave në fshatin Zhur ➤ Rregullimi i trotuarit, rrugicave dhe kanalizimit në fshatin Atmaxhë të Prizrenit;
<p>Përmirësimi i gjendjes infrastrukture në rrugët e Komunës së Prizrenit ,Shenjzim Vertikal dhe Horizontal – Barriera rrugore</p>	<ol style="list-style-type: none"> 5. Vendosja Shenjave Vertikale 6. Vendosja e Barrierave rrugore (Polic te Shtrire) 7. Vendosja e ‘‘Syte e Maces’’ 8. Vendosja e ‘‘ Anti parking’’ 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vazhdimi i punëve vendosja e shtyllave mbi katër zona në qytet Duke vazhduar, në bazë të kërkesave dhe nevojës në disa lagje dhe fshatrat e Komunës së Prizrenit. - Punët e inspektimit te rregullt të transportit rrugorë dhe komunikacionit të rrugëve publike, - Konrolli mbi Sinjalizimin Horizontal dhe Vertikal në territorin e komunës së Prizrenit, - Inspektimin se a kryhen në mënyrën e përcaktuar kontrollet teknike të automjeteve dhe rregullsinë e automjeteve, auto taxi, bus etj. - Inspektimin se a po aplikohen tarifat dhe qmimet për transportin publik në

		<p>komunikacion rrugorë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbikqyrjen e gjendjes së rrugëve publike, të mirëmbajtjes së drejt të rrugëve publike për komunikacion të sigurtë - Zbatimi i dispozitave teknike, normativave standarteve teknike me rastin e punimeve dhe punimi i materialit gjat punimit, siguria ne rruge - Inspektimi i auto taksive dhe autobuseve lokal - Detyrat dhe obligimet që përcakton referati i punës, Drejtori Kordinatori - <p>Kërkesat për kyqje në rrugë, shenjëzim, dalje në teren etj</p> <p>Vendosja e Emërtimeve, tabelat në rrugët lagjet e qyteti të Prizrenit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kërkesa për Qasje në rrugë ➤ Për auto taxi, Radio taxi ➤ Vazhdimi i linjave të transportit ➤ Dalja ne teren sipas kërkesave, ➤ Kontrolla e rregullt, ➤ Mbyllja e hyrjes për shatërvan nga rruga ‘‘Papa Gjon Pali II’’etj.
Përgatitja e tenderit për festa mjedisore	Shpalljen e tenderit për furnizim me material për festat mjedisore -	Takim pune me anetaret e stafit te SMM-se per planifikim
Përgatitja e tenderit për menaxhimin në deponinë e Zhurit	Hartimi i dokumenteve (marrëveshja, shpallja, kushtet teknike etj...).	Takim pune me anetaret e stafit te SMM-se per planifikim
Hartimi dhe projektimi dhe në sipërfaqet e gjelbra të hapësirave publike ne qytetin e Prizrenit	Identifikimi i hapësirave , pastaj pritet te organizohet nje takim me akteret kyqes te kontratave qe do te inkorporohen në rregullimin e ketyre siperfaqeve	
Takim me Institutin per Trashëgimi Natyrore bashkëpunim me MMPH	Lidhur me njoftimin për identifikimin e objekteve natyrore për kategorizimin si trashëgimi natyrore.	

PTK- fillimi i shpërndarjes së faturave për mbeturina	Sipas kontratës fillon shpërndarja e kontingjentit të parë.	Vazhdon shpërndarja , raportohet për çdo javë lidhur me nr e faturave të shpërndara
Raporti vjetor i mbeturinave	Mbledhja e të dhënave për raportin e mbeturinave nga kompanitë	
Përpilimi i planit të veprimit të SMM	Plani i veprimit për vitin 2019, - detyrat dhe rolet e ndara	
Takim me kompanitë	<ol style="list-style-type: none"> 1. “Nabs” dhe “ARBOR Group shpk, lidhur me ecurinë e punimeve dhe percaktimi I lokacioneve në vazhdimë 2. Takim me kompanitë shërbyese për grumbullim të mbeturinave 	Intervenimi i rrethojave ekzistuese
Intervenimi i rrethojave ekzistuese	<p>Ne terren është bërë identifikimi i vendeve se ku duhet të bëhet riparimi dhe veshja ose drrasimi me të rejtat:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ortakoll-Renovimi i rrethojave të dëmtuara- përballë “ABI” 	Takim me AKM
Hapësirat e gjelbra	<p>Intervenimet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lakuriq-1,3- vendosja e NP, inventari urban, kontejnerë • Ortakoll-2 - vendosja e NP, inventari urban, kontejnerë • Bazhdarhana-rregullimi i gjelbërimit dhe inventarizimi 	Dita e mjedisit
Dita e mjedisit	Planifikimi për shenimin e kësaj dite	

Inspektimi nga inspektorët e mjedisit	NSH"LRIP", Tulltorja në landovicë, Çesko, Arif Isaja, Parku i qytetit, Vlashnje etj , sipas kerkesave	
--	---	--

DREJTORIA E ADMINISTRATËS

Rezultatet kryesore / të arriturat gjatë kësaj periudhe janë:

- **Harmonizimi i pagave/koeficienteve për punëtorët e administratës**

Me datën 1 gusht 2018 është marrë vendimi nga MAP me të cilin është aprovuar harmonizimi i pagave për punëtorët e administratës komunale të Prizrenit, por implementimi i këtij vendimi nuk është bërë nga ana Zyrës së Thesarit të MEF pa ndonjë arsye konkrete gjatë viti 2018. Nga muaji janar 2019 ky Vendim ka filluar të zbatohet, nga i cili vendim rreth 288 punëtorëve të Administratës Komunale iu është harmonizuar paga.

- **One-stop shop në objektin e Administratës**

Aplikimi i modelit të ri të ofrimit të integruar të shërbimeve publike me qytetarin në qendër, ky projekt është duke u realizuar së bashku me MAP-in dhe tani është në fazën e projektimit. Ky model i ri i shërbimit synon të kursejë qytetarët në kohë dhe energji dhe t'u sigurojë atyre cilësinë e duhur të shërbimit. Me synimin për thjeshtësimin dhe standardizimin e procedurave administrative, digjitalizimin e shërbimeve, krijimin e sistemeve të teknologjisë informative dhe zgjerimit të fushave për marrjen e informacionit të shpejtë dhe të saktë të shërbimeve për qytetarë. DA përmes projekti me Bankën Botërore është në fazën e fundit të përcaktimit të procedurave dhe shërbimeve administrative komunale, me qëllim të krijimit të Kartelës së Shërbimeve.

- **E-kiosku**

Ky është vetëshërbimi digjital për certifikatat, ekstraktet apo shërbimet e gjendjes civile. Qytetarët të cilët janë të regjistruar në regjistrin civil si dhe të cilët kanë nxjerrë edhe më parë një ekstrakt, në çfarëdo kohe përmes një procesi tejet të thjeshtë, me letërnjoftimin e tyre mund t'i shtypin vet dokumentet e gjendjes civile. Janë funksionalizuar 2 E-kiosqe dhe brenda muajit Korrik 2019 do të funksionalizohen të gjitha këto E –kiosqe.

- **Themelimi i Forumit të OJQ-ve**

Forumi paraqet një mundësi për OJQ-të që të shkëmbejnë rregullisht informata mbi aktivitetet e vazhdueshme dhe të hulumtojnë lëmitë e sinergjisë, të parashtrijë çështje para komunës dhe të marrin informata kthyesë, por gjithashtu t'i mundësojë komunës mundësi për të bashkëvepruar drejtpërdrejtë me OJQ-të për çështje specifike që bien nën kompetencat e secilit departament të komunës. Një forum i tillë gjithashtu do jetë një mundësi për të shqyrtuar çështje me interes për të gjitha OJQ-të, pavarësisht komunitetit të tyre. Përveç kësaj, ngjarja synon të theksojë rëndësinë e krijimit të bazës së të dhënave të OJQ-ve për shkëmbimin e mëtejshëm të informatave dhe mundësive për bashkëpunim. Kjo bazë e të dhënave do të jetë publike dhe e qasshme nga publiku.

- **Arkivimi i lëndëve**

Drejtorja e Administratës ka filluar fazën e parë të projektit të skanimit të të gjitha dokumenteve administrative komunale të cilat pastaj do të arkivohen dhe do të integrohen në sistemin e e-Arhivës.

- **Rregullorja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve të cilët jetojnë në territorin e Komunës së Prizrenit dhe përcaktimi i masave dhe veprimeve të cilat duhet të ndërmerren nga organet e Komunës së Prizrenit me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në frymën e Konventës mbi të drejtat e fëmijës, të

miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë fëmijët pavarësisht gjinisë, etnisë, gjuhës, religjionit, pasurisë, aftësisë së kufizuar, prejardhjes familjare të fëmijëve, prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjor dhe veçanërisht për fëmijët e marginalizuar.

- **Mbështetja financiare për OJQ dhe subjektet tjera**

Gjatë kësaj periudhe janë mbështetur shumë aktivitete, shumë OJQ dhe subjekte tjera, sidomos ato organizata ku për fokus kanë pasur të drejtat e fëmijëve, barazinë gjinore dhe integrimin e komuniteteve.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

- Prej datës 3 janar Drejtoria e Shëndetësisë me qëllim të riorganizimit të departamenteve dhe njësive të Kujdesit Parësor Shëndetësor ka caktuar të gjithë shefat dhe kryeshefat e departamenteve dhe të njësive.
- Duke filluar nga muaji janar në QKMF –Prizren ka filluar ofrimi i shërbimeve laboratorike për analiza të hormoneve të gjëndrës tiroide, fraksionet e yndyrëave dhe Analiza ASTO.
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) që nga muaji mars i këtij viti ka filluar të ofrojë shërbime mjekësore 24 orë për qytetarët e Komunës së Prizrenit. Ndërkaq QMF-të në qytet, fshatrat Reçanë dhe Zhur janë duke punuar me dy ndërrime. Në kuadër të këtij riorganizimi ka filluar të punojë QMF Reçane me dy ndërrime si dhe është krijuar mundësia që në QMF Reçanë të fillojnë analizat laboratorike bazike.
- Në kuadër të riorganizimit është edhe krijimi i njësisë së diabetit, riorganizimi i qendrës së mirëqenies së gruas, ofrimi i shërbimit të PAP Testit dhe riorganizimi i shërbimit të vaksinimit.
- Të gjithë mjekët dhe zyrat e tyre janë të pajisur me aparaturë bazike për të kryer veprimtarinë shëndetësore. Çdo QMF dhe është e pajisur me EKG, Inhalator dhe me Ultrazë. Njësia e Radiologjisë është pajisur me Ultrazë dhe Mamograf (Skriningu i Gjirit).
- Në muajin maj është furnizuar me aparaturë të re Laboratorike Autoanajlizer me kapacitet prej 800 analizash në ore.
- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Prizren ka përfituar një donacion për produkte medicinale, përkatësisht ilaçin Amoxicillin në vlerë prej 23,028.20 dollarë.
- Gjithashtu nga granti i përfituar nga Demosi për performancë të mirë, janë ndarë edhe 40,000 euro për pajisje medicinale.
- Drejtoria e Shëndetësisë ka filluar edhe me ofrimin e shërbimit të Kujdesit Paliativ, me ç’rast banorët e komunës së Prizrenit, përkatësisht personat që vuajnë nga sëmundjet kronike dhe janë në fazën terminale do të kenë mundësi t’i kryejnë kontrollet mjekësore nga shtëpitë e tyre.
- Me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore, janë ndërmarrë të gjitha hapat për Edukimin e Vazhdueshem Profesional të stafit. Çdo javë në ambientet e QKMF-së organizohen ligjerata dhe trajnime me stafin e mesëm dhe mjekët.
- Në muajt maj-qershor, një grup prej 4 mjekësh, specialistë të Mjekësisë Familjare, janë trajnuar në Qendrën Trajnuese për Ultrazë në Tirane, për ultrazë nga Ultrasonografia e Abdomenit. Në shtator do të shkojë grupi i dytë.
- Me qëllim të realizimit të projektit të minikirurgjisë, ka filluar trajnimi i mjekëve të cilët do të merren me minikirurgji. Është trajnuar dhe aftësuar ekipi për Kujdes Paliativ. Së shpejti do të fillojë trajnimi i stafit shëndetësor për mjekesi familjare Online.
- Gjithashtu gjatë këtij viti është paraparë që të bëhen trajnime edhe për ultrazë të gjirit, mamografi dhe elastografi.
- Gjatë periudhës mars-maj, Drejtoria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit dhe Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare kanë realizuar të gjitha vizitat sistematike shëndetësore të nxënësve të klasës së parë, të pestë dhe të nëntë. Gjatë këtij procesi janë vizituar gjithsej 56 shkolla dhe janë kontrolluar mbi 7 mijë nxënës.
- Janë në proces të perfundimit dy objekte shëndetësore – QMF Romajë dhe QMF Lubizhdë, ndërsa është në procedurë është edhe fillimi i QMF në Gjonaj.
- Në muajin maj ka përfunduar konkursi ku janë pranuar 7 mjekë dhe 10 staf i mesëm.

DREJTORIA E INSPEKTORATEVE

Sektori inspektoratit të Tregut:

6 mujori i parë i Sektorit të Inspektoratit të punës dallohet me dinamizëm të shtuar dhe vëllim me të madh të punës. Përpos planifikimit të punës ndikim në rritjen e vëllimit kanë edhe kërkesat e institucioneve të tjera me të cilat Drjtoria obligohet që të bashkëpunojë si: Policia e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Administrata Tatimore e Kosovës, si dhe reagimet dhe denoncimet e qytetarëve.

- Në këtë periudhë kohore janë inspektuar 40 lokale të akomodimit, hotele, motele dhe shtëpiza –pushimore ditore, kafenetë, restorantet me dhoma etj.
- Janë inspektuar pompat e benzinës dhe derivateve, janë urdhëruar me proces verbale dhe aktvendime, pikat e të cilave iu ka kaluar afati i vulosjes.
- Inspektimi i disa bizneseve (një është gjetur) që bën prodhimin e veshjeve sportive dhe plason ne treg me shenja të mbrojtura.
- Janë inspektuar të gjitha marketet, hipermarketet (32) dhe të gjitha minimarketet në qytetin e Prizrenit.
- Është bërë inspektimi në zbatim të Urdhëresës së MTI-së nr.01/301 të datës 21.02.2019, me ç'rast janë kontrolluar bizneset që shesin mallra serbe dhe të njëjta supozohet së janë të kontrabanduara, ku për këtë urdhëresë janë poashtu të njoftuara të gjitha bizneset. Nuk janë gjetur mallra serbe pas vendosjes së taksës 100%.
- Në kuadër të planifikimeve janë inspektuar bizneset artare dhe argjendarë, për arsye të verifikimit për vulosjen e peshoreve elektronike. Po ashtu është bërë edhe inspektimi i peshoreve të furrave të bukës. Në muajin mars është ndërmarrë aksioni i inspektimit në kuadër të përgjegjësi në bazë të ligjit për Qendrën
- Historike të Prizrenit, në lokale ku dyshohej se ilegalisht ushtrohej veprimtaria e ndaluar sipas këti ligji për lojëra të fatit dhe kazinove. Të gjitha lokalet e gjetura në asistim të Policisë së Kosovës janë të mbyllura.

Inspektorati Sanitar:

Sektori i inspektorëve Sanitar është bartës i përgjegjësisë më të madhe në çështjen e mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve përmes fushëveprimit të tyre në inspektim. Vetëm në këtë periudhë është bërë inspektimi i:

- objekteve tregtare ku bëhet qarkullimi dhe shitja e artikujve ushqimor me pakicë dhe shumicë,
- objektet hoteliere në urdhëres të zbatimit të masave të DDD (dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim) ,
- sallone dasmash (41 janë në qytetin e Prizrenit) para fillimit të sezonit ,
- sallone të zbukurimit,
- objektet e prodhimit të ëmbëlsirave,
- mishtoret,
- Inspektimi i barnatoreve humane me pakicë të ordinancave të ndryshme mjekësore,
- çerdhet dhe entet për edukim të fëmijëve parashkollor,
- dyqanet që shesin preparatet kozmetike dhe për mirëmbajtje higjienike,
- inspektimi i tregut të bylmetit,
- inspektimi i objekteve me ujë të pishëm dhe ujë të pijshëm me anë të marrjes së mostrave të ujit për analizë,
- objektet për sport dhe rekreacion si pishinat dhe fushat (qendrat) rekreative

Inspektorati Veterinar

Puna dhe angazhimi në sektorin e inspektorave Veterinar në këtë periudhë kohore është bërë në kuadër të përgjegjësi ligjore që i takojnë këtij sektori. Punë në heshtje e me mbikqyrjen permanente shpesh është bërë lajm i mirë prituri nga vet qytetaret , kur bëhet fjalë për sasi të mishit të konfiskuar me afate të skadimit. Kjo punë ka bërë që të rritet besueshmeria e qytetarëve në konsumimin e sigurt të mishit dhe produkteve të tij.

Puna e këtij sektori me përgjegjësi është bërë në;

- -mbikqyrja dhe kontrollimi i artikujve ushqimor me prejardhje shtazore në prodhim, qarkullim dhe deponim
- kontrollimi i kafshëve për therrje dhe kontrollimi i mishit në linjen e therrjes në thertore

- -kontrollimi në fabrikat e përpunimit të mishit dhe nën produkteve të mishit
- -kontrollimi i qumështoreve
- -kontrollimi I fermave të pulave
- -kontrollimi i të gjitha mishit private
- -kontrollimi të DPT dhe DHP-ve
- -asgjësimi I mishit dhe nënprodukteve të mishit
- -kontrollimi I frigoriferëve me kapacitet të lartë

Inspektorati i Bujqësisë

Sektori I inspektorëve të bujqësisë në punën 6 mujore sipas planifikimit të punës fokus të veçantë të inspektimit ka bërë në pikat e poshtë përmendura :

- Është inspektuar çdo lëmi në aspektin e bujqësisë dhe Hidroekonomisë :
- Prodhimet ushqimore me prejardhje bimore-nëpër dyqane
- Barnatoret bujqësore
- Pijet alkoolike
- Kualiteti i miellit- dhe prodhimet nga mielli (Furrat)
- Ndërmarrjet që plasojnë farëra dhe plehra minerale
- Tokat bujqësore sipas rasteve
- Autotransportuesit e rërës
- Ekspliatuesit e rërës dhe gurit natyror
- Resurset ujore si dhe KRU ”Radoniqi&Dukagjini”

Gjatë muajit Prill-Qershor sektori i inspektorëve të Bujqësisë së bashku me inspektorët e MMPH-së, me kërkesë të Policisë së krimeve ekonomike kanë inspektuar të gjitha seperacionet, betonjerat, prodhuesit e elementeve të betonit në kontrollim të gjendjes në të gjithë regjionin e Prizrenit. Ky aksion ka rezultuar shumë i suksesshëm ngase për herë të parë janë inspektuar detajisht të gjitha këto biznese nga intitucionet përgjegjëse për mbikqyrje.

Përgjatë muajit mars në bashkëveprim me inspektorët sanitar janë inspektuar të gjitha furrat e bukës, në qytetin e Prizrenit. Në muajin maj së bashku me federatën e peshkatarëve është zhvilluar aksioni për ndalimin e gjuajtjes së Krapit. Ndërsa në muajin qershor fokusim të veçantë iu është kushtuar inspektimit të dyqaneve ushqimore ku janë inspektuar prodhimet me origjinë bimore.

Inspektorati Komunal

Ky sektor gjatë 6 mujorit të parë i ka kushtuar vëmendje largimit të pikave të zeza të mbeturinave në qytet, veçmas në lagjet periferike të qytetit. Poashtu është bërë inspekstimi i lokaleve afariste të cilat kanë obligim për të lidhur kontrat “ Eko-Regjion” Sh.A. Prizren apo me ndonjë ndërmarrje tjetër të autorizuar për mbajtjen e mbeturinave.

Me sukses ka përfunduar kontrollimi i bizneseve të cilat ekspozojnë tavolina jashtë lokaleve afariste në hapësirën publike. Në periudhën e parë të vitit 2019 deri më tani janë pajisur me leje mbi 90% të lokave të evidentuar, janë liruar disa hapësira publike në aksione si në rrugën “Sheshi Shatërvan”, “Shuaip Spahiu”, “Sheshi i Lidhjes” dhe “Edit Durham” .

Në gjashtë mujorin e par janë bërë 34 rrënime, prej tyre në 18 raste qytetarët në mënyrë vullnetare kanë zbatuar urdhërat e Inspektoratit, kurse në 16 raste të tjera është dashur të bëhet rrënim i dhunshëm.

Inspektorati i Ndërtimtarisë

Ky sektor përgjatë muajit Janar dhe Shkurt është marrë me largimin – rrënimin e të gjitha konstrukcioneve metalike të cilët ishin të vendosura përbrenda QHP-së, e që ishin të kundërligjishme dhe pa leje nga DUPH, ku gjithsej 23 konstrukcione metalike të lokaleve afarsite jane larguar, prej tyre në 6 raste është dashur të bëhet largimi i dhunshem nga DI.

Në fillim te vitit është bërë një rrënim në tokën bujqësore, ku me ndërtim është tentuar që të uzurpohet prona e ish nëdrrmarjes Progres, që tani menxhohet nga AKP-ja. Po ashtu janë zhvilluar edhe disa rrënime, është bërë rrënim

lirimi në rrugën Qene Qenaj, në lagjen Jeta e re. Në këtë rrënim janë rrënuar kryesisht murre uzurpuese dhe një aneks shëpie.

Me fillimin e punimeve ndërtimore, ky sector një fokusim të veçantë ka kushtuar te objektet e ndërtimit të lartë afaristo banesor si dhe edhe në objektet e ndërtimit të shtëpive individuale. Në këtë periudhë po ashtu është intervenuar në dy raste, me rrënim të një objekti shtëpi individuale banimi si dhe rrënim të një objekti afaristo banesor me etazhitet e tejkaluara në ndërtim.

Për të njëjtën vepër është intervenuar edhe përmbrnda QHP-së, ku qytetari pavarësisht lejes ndërtimore ne zonë të veçantë të mbrojtur me ligj ka mbindërtuar kundërligjshëm. Poashtu me kërkesë të DSHP dhe me procedurë të sektorit të pronës është intervenuar me rrënim të ish Tregut të gjelbërt në lagjen Terzimahall (pas Gjimnazit) pasi që nga ish shfrytëzuesi nuk është kthyer në gjendje të mëparshme.

	Bujqesia	Tre gu	Sanitar	Komunal	Veterinar ise	Ndertim arise	Gjithesej
Proqesverbal	461	1108	611	506	679	375	3740
Aktvendim	37	523	258	159	27	44	1048
Aktvendim per rrenim	-	-	-	-	-	23konstrukcio ne metalike, 6 te rrenuara dhunshem .10 rrenime tedhunshme. Dhe 1 vullnetar	34
Konkluzione	-	-	-	-	-	34	34
Proqesverbal per ekzekutim	-	-	-	1	-	5	6
Kerkese per kundervajtje	22		28	2	3	60	115
Kerkesa per vepra penale	-	-	-	-	-	6	6
Kerkese per kontrollin e therjeve					1016 Gjedh e 18 Qingja	-	1034
Kerkesa gjykates		19				-	19
Asgjesim I mallrash	110,8 5 €	1485 €	48777.7 €	85 €	2772. 47 €	-	53.231.€
Pelqimi teknik	-	191	-	-	-	-	191
Denimet nga gjykata	3420 €	4580 €	6925 €	1325 €	1350 €	500 €	18.100 €
Denime mandatore				50 €		-	50 €

Kerkesa te paleve	-	18			12	-	30
Reklamacione	-		-	-	-	-	
Refuzime		3				-	3
Te hyrat ne DI							22,436.50 € apo 64.10%

Pasqyra tabelore e punës së drejtorisë së inspektorateve për periudhën janar-qershor 2019

DREJTORIA E BUJQËSISË

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural gjatë periudhës raportuese, aktivitetin e vet e ka zhvilluar në bazë të prioriteteve të përcaktuara me Planin e Punës 2019 bazuar në Strategjinë Komunale për Bujqësi 2017-2019/20, Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të Kosovës 2014 - 2020, Planit Zhvillimor Komunal, vendimeve, akteve tjera normative si dhe bashkëpunimin me shoqatat e fermerëve dhe grupet tjera.

Në vazhdimësi është punuar që të kemi bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural më të avancuar në krahasuar me periudhë paraprake, me rritje të qëndrueshme të prodhimit, rritje të sigurisë ushqimore dhe cilësisë, marketing të përmirësuar të produkteve agro ushqimore dhe menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore si toka, pyjet, ujërat dhe biodiversiteti.

I tërë aktiviteti i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural është zhvilluar sipas sektorëve:

- **Sektori i Bujqësisë**
- **Sektori i Zhvillimit Rural**
- **Sektori i Pylltarisë**
-

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar gjithsej 1261 kërkesa me shkrim nga lami të ndryshme, ose 441 kërkesa me shumë se në vitin 2018, si dhe janë proceduar 1050 aplikime e që është 199 aplikime më shumë se në vitin 2018 (891 aplikime 2018) fletë aplikime në kuadër të masave për mbështetje direk të sektorit e blegtorisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimeve për MBPZHR.

SEKTORI I BUJQËSISË

Aktivitete kryesore ka pasur: realizimin e projekteve kapitale të financuara nga Kuvendi Komunal, monitorimin e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore, organizimin e fushatës së korrije shirjeve, bashkëpunimin me organizatat e ndryshme për përmirësimin e pozitës së fermerëve, vlerësimin e dëmeve të fushës dhe dëmeve nga fatkeqësitë elementare si dhe mbajtjen e evidencës për tokën bujqësore (të papunuar, të dhënë në shfrytëzim dhe të cilës i është ndërruar destinimi i shfrytëzimit).

Projektet e realizuara

Furnizimi me farë misri
Furnizimi i fermerëve me foli plastike-perime fushë e hapur dhe agrofoli-serrë
Furnizimi me lopë qumështore me participim

Projektet në realizim

Dezinsektimi dhe derratizimi i qytetit dhe zonat periferike
Trajtimi i qenve endacak
Ngritja e stallave për lopë qumështore me participim
Furnizimi me mekanizim bujqësorë me participim
Ngritja e stallave për dele me participim
Pjelloria e tokës dhe rekomandimi për plehërim
Ngritja e pemishteve me pemë të imta(mjedra,manaferra,dredhëza) me participim

Përshkrimin i projekteve:

1.“Subvencionimi i fermerëve me farë misrit”.

Është subvencionuar mbjellje e 600 ha. me farë misëri. Përfitues janë 574 fermerët e komunës së Prizrenit të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara. Shuma e projektit 21.742 €.

2. Furnizimi i fermerëve me foli plastike.

Janë furnizuar 170 fermer me foli plastike kultivues të perimeve në fushë të hapur me nga 52 kg. dhe 19 fermere me agrofoli për kultivuesit e perimeve në ambiente të mbrojtura – serra.

3. Furnizimi i fermerëve me lopë qumështore.

Ky projekt ka për qëllim rritjen e kapacitetit prodhues të fermës e njëkohësisht edhe përmirësimin racor te gjedhet për prodhimtari intensive të qumështit. Janë furnizuar 99 fermerë me lopë qumështore të cilët i kanë plotësuar kriteret e aplikimit nga 197 aplikues. Vlera e këtij projekti është 153.252 €. Krahasuar me vitin paraprak (2018) kur janë furnizuar 80 fermer paraqet rritje prej 23.75 % të mbështetjes financiare për blegtorët që merren me mbarëshkrimin e lopëve qumështore.

4. Dezinsektimi, dezinfektimi dhe derratizimi i qytetit. Qëllimi i këtij projekti është marrja e masave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe krijimin e kushteve të përshtatshme përmes eliminimit të insekteve, brejtësve dhe sëmundjeve të ndryshme në hapësirat publike të qytetit (parku i qytetit, rrjedha e lumit Lumëbardhi, hapësirat e gjelbra në qytet, ambientet e mbyllura për ruajtjen e materiali arkivor, varrezat, strehimoret, etj). Deri më tani është realizuar faza e parë e dezinfektimit të të gjitha zonave të planifikuara dhe derratizimi i kanalizimeve dhe bodrumeve të objekteve të banimit kolektiv.

5. Trajtimi i qenve endacak me metodën e eutanazisë.

Me këtë projekt po arrihet mbajtja nën kontroll dhe parandalimin i përhapjes së sëmundjes së Tërbimit tek kafshët. Deri më tani janë trajtuar 330 qenë endacak sipas normave standarde dhe praktikave mjekësore veterinarë si dhe ndërmarrjen e masave preventive përmes vaksinimit, trajtimit, etj. Projekti vazhdon sipas dinamikës së planifikuar.

6. “Ngritja e stallave për bagëti”

Përmirësimi i pozitës së fermerë sa i përket mbarështimit të lopëve qumështore, deleve dhe dhive është një nga prioritetet e zhvillimit të qëndrueshëm lokal të komunës së Prizrenit. Për arritjen e këtij synimi është bërë përzgjedhja e fermerëve përfitues: 8 fermerë për ngritjen e stallave për dele dhe 9 fermerë për stalla të lopëve qumështore. Projekti vazhdon në fazat tjera të nënshkrimit të marrëveshjeve për bashkëfinancim dhe punëve tjera përgatitore.

7. “Furnizimi me motokultivator dhe mjete të imta bujqësore”

Realizimi kualitativ i punëve të fushë është një prej faktorëve kyç për rritjen e prodhimit. Për këtë qëllim jemi në implementim e sipër të këtij projekti i cili gjendet në fazën e vlerësimit të aplikacioneve. Me mekanizim bujqësor do të furnizohen 100 fermerë që merren me kultivimin e perimeve në ambiente të mbrojtura (serra) dhe në fushë të hapur. Deri më tani kanë aplikuar rreth 300 fermer për përfitim nga ky projekt.

8. Pjelloria e tokës dhe rekomandimi për plehërim”

Ky projekt është në realizim e sipër sipas dinamikës së planifikuar dhe ka të bëjë me realizimin e analizave agrokimike të tokave bujqësore në sipërfaqe prej 2.000 ha. në zonat kadastrale të Vrrinit. Me këto analiza do të përcaktohet: niveli i materies organike, pH-ja e tokës, përmbajtja e materieve aktive për makro dhe mikro elemente, si dhe rekomandimi për plehërim. Deri më tani është realizuar marrja e mostrave në terren dhe në vazhdim e sipër është pjesa analitike në laborator.

9. Ngritja e pemishteve me pemë të imta.

Projekti është në realizim e sipër. Deri më tani është bërë përzgjedhja e fermerëve, nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëfinancim dhe fillimi i punëve përgatitore në terren. Do të mbillen 2 ha. dhe përfitues janë 8 fermerë.

SEKTORI I ZHVILLIMIT RURAL

Janë realizuar një mori aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e standardit të ekonomive bujqësore duke përfshirë edhe ato të diversifikimit rural si masë shtesë e rritjes së të ardhurave. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që fermerët të bëhen të pavarur në menaxhimin e fermave të tyre.

Me këtë kemi arritur të bëjmë një klasifikim të plotë të kategorive të fermerëve që në të ardhmen do të na shërbejnë në realizimin e projekteve madhore.

Përveç realizimit të objektivave të parapara nga drejtoria, sektori i Zhvillimit Rural ka bashkëpunuar edhe me shumë organizata qeveritare e jo qeveritare me qëllim të përmirësimit të situatës në fermat bujqësore dhe ekonomit rurale.

Aktivitetet tjera:

- Zhvillimi i zonave rurale përmes avancimit të shërbimeve këshillimore dhe krijimi i rrjetit të të dhënave.
- Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore është lejuar për 5 raste në sipërfaqe prej 10242 m² dhe janë inkasuar 8,315.50 €.
- Monitorimi i mbjelljeve pranverore, vjeshtore dhe përgatitjet për korrje.

Bazuar në Planin e Punës për vitin 2019, në harmoni me kompetencat e veta dhe kërkesat e punës, drejtorja ka kryer aktivitetet e parapara të kontrollit fizik në terren, verifikimi i deklarimeve të përfituesve, hartimi me shkrim i të gjeturave dhe formulimi i Raporteve të Kontrollit si dhe informimi për të gjeturat, konstatimet dhe nivelin e realizimit të projekteve.

Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural varësisht prej nevojës është angazhuar në mënyrë aktive edhe në shumë aktivitete tjera të iniciuara nga autoritete të ndryshme publike në nivel lokal, regjional dhe qendrore.

SEKTORIT I PYLLTARISË

Në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 1.3. (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi degën e ekzekutivit të Institucioneve të Vetëqeverisjes në Kosovë, dhe nenit 20,25 dhe 29 të Ligjit për pyjet e Kosovës Nr. 2003/3 të dt. 20 mars 2003, nenit 12 pika 29.8 të Ligjit nr. 03/L-153 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/3 për pyjet e Kosovës, UA-05,06,07 /2010 si dhe Memorandumit të Mirëkuptimit mes MBPZHR dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës

NJËSITË PYJORE janë kompetencë e deleguar në Komuna nga MBPZHR-APK-së

Pylltaria ndahet në tre sektorë;

1. Sektori i Mbrojtjes së Pyllit – gjatë kësaj periudhe janë ngritur 31 fletëparaqitje për kundërvajtje dhe 4 fletëparaqitje penale ndaj uzurpatorëve të tokave pyjore, janë realizuar 160 kontrole ditën dhe 60 natën. Janë mbajtur 86 seanca gjyqësore.

2. Sektori i Shfrytëzimit të Pyllit – janë tenderuar 1275.20 m³ dru në këmbë, derisa 431.84 m³ është furnizuar popullata e zonave rurale. Janë konfiskuar 96.60 m³ dru dhe 13 thasë thëngjill. Është intervenuar në 10 raste të zjarreve dhe janë realizuar 60 kontrollat të natës.

3. Sektori i pyjet private- janë pranuar 48 kërkesa të pronarëve për prerje në pyjet private

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Drejtorja komunale e Arsimit në Prizren, gjatë muajit janar të vitit 2019, i ka realizuar të gjitha punët dhe detyrat e planifikuara sipas dinamikës së paraparë për këtë periudhë kohore, por njëkohësisht edhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

Aktivitetet e planifikuara dhe të implementuara për Janar – Qershor 2019 në sektorin e arsimit:

- Monitorimi i procesit mësimor zbatimi i Kurikulës së Re në shkollat e komunës së Prizrenit;
- Përkrahje e koordinatorëve të cilësisë me bazë në shkollë në monitorimin e zbatimit të KK-së;
- Fuqizimi dhe përkrahja e aktiveve profesionale në shkollë në zbatim të kurrikulës së re;
- Përpilimi i listave të mësimdhënësve sipas fushave të KK-së nga të gjitha shkollat;
- Konsultimi me trajnerë të Kurrikulës dhe me drejtorë të shkollave për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve të mësimdhënësve në zbatimin në praktik të Kurrikulës së Re;
- Mbështetja e trajnerëve dhe mësimdhënësve me materiale logjistike dhe udhëzues të Kurrikulës së Re, si dhe mjete tjera të nevojshme për trajnim;
- Trajnimi i 206 mësimdhënësve për zbatimin në praktik të kurrikulës së re;
- Vlerësimi i portofoliove (dosjeve) të mësimdhënësve në zbatim të kurrikulës së re;

- Përfshirja e nxënësve të të gjitha shkollave dhe nivele në regjistrim e nxënësve në klasën e dhjetë në shkolla profesionale dhe gjimnaze;
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e procesit mësimor në shkollat e komunës dhe zbatimimi i KK-së në klasët parafillore dhe nivelin 1, 2 e 3;
- Planifikimi i profileve, drejtimeve dhe paraleleve regjistrimin e nxënësve në klasë të dhjetë;
- Konkursët për regjistrim të nxënësve në klasë të dhjetë në shkollat e mesme të larta;
- Regjistrimi i nxënësve në shkolla të mesme të larta;
- Konsultime me zyrtarë tjerë në DKA për monitorimin e gjendjes në procesin edukativo – arsimor;
- Matura Shtetërore 2019;
- Grumbullimi i të dhënave për nxënësit nga shkollat për Maturën Shtetërore 2019;
- Përgatitja, mbajtja dhe analizimi i rezultateve të Provimit të Maturës Shtetërore 2019;
- Testi TIMMS;
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e procesit mësimor në shkollat e mesme të larta;
- Grumbullimi dhe plotësimi i Databazës së Zhvillimit Profesional të Mësimdhënësve (ZHPM);
- Plani Zhvillimor i Shkollave në ZHPM;
- Rekomandime drejtorëve në realizimin e planit vjetor dhe të punës së tyre;
- Trajnimet e mësimdhënësve në: MKLSH dhe Vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të nxënësve;
- Trajnime për gjithëpërfshirje;
- Trajnimet e Kurrikulës së Re;
- Raporte për vizitat nëpër shkolla e mesme të larta;
- Rekomandime drejtorëve në realizimin e planit vjetor dhe të punës së tyre;
- Konsultime me zyrtarë tjerë në DKA për monitorimin e gjendjes në shkollat e mesme të larta;
- Bashkëpunim në inspektoratin e arsimit në Prizren në Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve;
- Mbikëqyrja e Planit vjetor në zbatim të PZSHH në udhëheqjen e shkollës dhe mbikëqyrja e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe vlerësimi periodik dhe të vazhdueshëm të nxënësve;
- Rekomandime me të gjitha shkollat e Komunës në zbatim të Planit Zhvillimor të Shkollave (PZSHH) nga Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve (ZHPM);
- Konsultime me MASHT për ZHPM dhe trajnime;
- Mbikëqyrja e Planit vjetor në zbatim të PZSHH në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Rekomandime të gjitha shkollat e Komunës në zbatim të PZSHH dhe sigurimin e cilësisë në shkolla;
- Konsultime me MASHT;
- Përdorimi i mjeteve të konkretizimit dhe kabineit të informatikës për ngritje të cilësisë në shkollë;
- Konsultime me SIA dhe MASHT në zbatim të vendimeve të MASHT dhe të UA të MASHT;
- Monitorime të gjitha shkollave të Komunës në vlerësimin e nxënësve dhe ngritjen e cilësisë në shkollë;
- Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme qeveritare (MASHT), Institutin pedagogjik, KEC, GIZ etj.;
- Furnizimi i institucioneve parashkollore me mjete didaktike dhe rekuizita;

- Furnizimi i shkollave me pako minimale të mjeteve të konkretizimit, përfshirë pajisjet laboratorike;
- Furnizimi sistematik i institucioneve arsimore me naftë për ngrohje;
- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit;
- Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prizrenit, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë muajit janar, kanë realizuar **vizita** speciale dhe kontrolluese në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit janar;

Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi profesional komunal për monitrimin dhe vlerësimin e fëmijëve me nevoja të veçanta ka operuar sipas planifikimeve të parapara për adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet shkollore;

- Janë përpunuar dhe futur të dhëna statistikore në sistemin SMIA, nga të gjitha institucionet shkollore të nivelit të arsimit parauniversitar të komunës së Prizrenit;

Në kuadër të sektorit për furnizim dhe logjistikë në Drejtorinë Komunale të Arsimit janë kryer këto aktivitete:

- Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për inventarin e objekteve shkollore si dhe dorëzimi i dokumentacionit tek zyrtarja për pasuri, pranë Komunës.
- Pranimi i kërkesave për furnizim me materiale të ndryshme, nga ana e drejtorive të shkollave, si dhe klasifikimi i tyre sipas prioriteteve,
- Furnizimi me material për zyre për nevojat e DKA
- Pregatitjet rreth organizimit të manifestimeve për ditën e pavarësisë, ditën e mesuesit dhe ditën e abetares.
- Organizimi I përvjetorit të egzodit, pritjes së nxënësve nga Qyteti I Beratit.
- Kontrollimi I transportit të nxënësve në shkollat: “Vëllezërit Frashëri”-Gorozup, “Zenun Çoçaj” – Gjonaj, “Meto Bajraktari”-Lokvicë, “Mushnikova” – Drajqiq, “Naim Frasheri”-Myradem, “Heronjte e Lumes”-Vermice dhe “Bajram Curri” - Lukijë.
- Pranimi I kërkesave të shkollave për furnizim me inventar shkollore, lende djegëse për ngrohje dhe lyerje të objekteve shkollore.
- Shpallja e tenderit për inventar shkollore dhe lyerje të objekteve shkollore (projekti është në fazën e tenderimit)
- Pregatitja e dokumentacionit për shpalljen e tenderit për furnizim me lende djegëse për ngrohje (hapja e ofertave më 05.07.2019), me vlera të planifikuara, dru 220,000.00€ dhe pelet 200,000.00€)
- Terhekja dhe shpërndarja e “Petty Cash” për institucionet arsimore.
- Vizite pune nëpër institucionet arsimore.
- Pjesëmarrja në vlerësimin e ofertave të ndryshme nga investimet kapitale të DKA.

Pjesmarrja ne disa komisione te ndryshme, te caktuar nga Kryetari i Komunës

DREJTORIA E TURIZMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Sektori i Turizmit:

- **DTZHE** ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit për Komunën e Prizrenit, e cila është përgatitur ne bashkëpunim me Swiss Contact pas disa punëtorive te organizuara se bashku. Strategjia në fjalë është hartuar duke u bazuar ne Metodën e St.Gallen për Menaxhimin e destinacioneve.
- Per vitin kalendarik 2019 buxheti i planifikuar i drejtorisë është **1, 105.650** euro me rreth **15 Kode** buxhetore te ndara
- Gjatë periudhës 6 mujore të këtij viti drejtorja ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me organizata te ndryshme si:
- -Marrëveshja e bashkëpunimit me Organizaten Help-Komuna e Prizrenit
- -Marrëveshje bashkëpunimi me Germin-Komuna e Prizrenit
- -Marrëveshje bashkëpunimi me UNDP-Komuna e Prizrenit-ADA
- -Marrëveshje me AZHR-Komuna e Dragashit-Komuna e Prizrenit
- -Fondacioni Lombardhi- ChWB- Komuna e Prizrenit
- -Marrëveshje me Swiss Contact- Komuna e Prizrenit-SHB SHARRI
- -Marrëveshje ndermjet Aleancës Franceze ne Prishtine-Komunës Metropolitane të Parisit dhe Komunës së Prizrenit

Sektori i Zhvillimit Ekonomik:

- Drejtorja vazhdon me grante në përkrahjen e start up bizneseve dhe bizneseve ekzistuese, përkrahje për pajisje me asete bashkë me participim.
- Nga faza e dytë e projektit të granteve brenda periudhës 6 mujore të këtij viti kanë përfituar 8 biznese ekzistuese në Prizren, të udhëhequra nga meshkujt, dhe 5 biznese ekzistuese në Prizren te udhëhequra nga femrat.
- Me projektin Memorandum bashkëpunimi me Help “Mbështetja e stabilitetit socio-ekonomik në regjionin e Ballkanit Perëndimor 2019-2020” nga Komuna e Prizrenit kanë përfituar 45 biznese ekzistuese. Projekti ka arritur në fazën e lidhjes së kontratave në mes të përfituesve dhe Help si organizatë.
- Drejtorja ka realizuar thirrjen publike në përkrahje të subvencioneve për OJQ të cilat veprojnë në Komunën e Prizrenit në fushën e promovimit dhe afirmimit të sektorit te fushës së turizmit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, OJQ-ve që kontribuojnë në shtrirjen e kalendarit dhe aktiviteteve përgjatë tërë vitit, gjithashtu kontribuimit në zhvillimin e turizmit kulturor lokal , ngritjes së kapaciteteve ekonomike, dhe zhvillimit të ndërmarrësisë përmes aktiviteteve të OJQ-së.
- Edhe ne këtë vit kalendarik drejtorja ka mbështetur organizatat e ndryshme për realizimin e aktiviteteve të tyre , drejtoritë komunale, dhe institucione të ndryshme me asetet të cilat janë kompetencë e drejtorisë, si; zërimi, bina dhe tendat.
- Ka vazhduar me bashkëpunime në mes të institucioneve lokale dhe qendrore në lidhje me procedurat dhe implementimet e projekteve në fjalë, bashkëpunime të vazhdueshme me Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturorë , drejtoritë komunale si ajo e Urbanizmit dhe Shërbimeve Publike etj, shkolla të mesme profesionale – si ajo Ekonomike dhe e Kompetencës.
- Ne cilësinë e promovimit te turizmit te qytetit te Prizrenit, drejtorja ka qene pjese e Panirit Ndërkombëtar te Turizmit ne Tirane 2019, e cila ka prezantuar broshura dhe materiale tjera promovuese, si dhe ka qene pjesëmarrëse ne Panairin Ndërkombëtar te Artizanateve ne Bursa/Turqi.

- Sa i përket projekteve të planifikuara të vitit kalendarik 2019 , gjendja ekzistuese e procedurave dhe e implementimit është si ne tabelën me poshtë:

**PROJEKTET NË PROCEDURE TË PROKURIMIT DHE IMPLEMENTIMIT DHE
PROJEKTET E PERFUNDUARA TË DREJTORISË – PERIUDHA JANAR QERSHOR 2019**

Emri i projektit -	Procedura tenderuese dhe procedura e implementimit te projektit
Ndërtimi i Infrastrukturës ne Parkun Ekonomik ne Lubizhdë te Prizrenit –	-Projekti ne procedura te tenderimit -Para fazës se vlerësimit te tenderit
Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve malore	-Projekti ne implementim -Para fazës përfundimtare
Organizimi i Panaireve	-Ka përfunduar Faza e I-re e projektit “Panairi i Veshjeve Tradicionale”
Organizimi i Panaireve	Panairi i Prodhimeve vendore dhe artizanateve
Memorandum ne mes te Komunës se Prizrenit, Komunës se Dragashit dhe AZHR JUG	“Fuqizimi i turizmit rural dhe ambiental përmes qendrave te mençura informuese për turist”/FREET-STIC
Memorandum me Help dhe Komuna e Prizrenit -viti 2019	Projekti: Mbështetje e stabilitetit socio-ekonomik ne regionin e Ballkanit Perendimor. Projekti ka kaluar fazën e vlerësimit dhe te përfituesve dhe nënshkrimit te kontratave.
Memorandum ne mes te Komunës se Prizrenit , UNDP dhe ADA	Projekti: “Zyra për Zhvillim te gjelbër”
Memorandum ne mes te Komunës se Prizrenit dhe OJQ GERMIN	Projekti:”Forumi i Bashke-Investimit dhe rrjetëzimit” Projekti ne implementim e sipër
ZHVILLIMI I TURIZMIT KULTUROR	Projekti: Bashkëpunimi për zhvillimin e sektorit te turizmit, ne Komunën e Prizrenit. -STRATEGJIA- Memorandum bashkëpunimi ne mes te Komunës dhe Swiss Contact

“Krijimi dhe Mirëmbajtja e Web Faqes” (projekt 3 vjeçar 2019-2022)	Projekti ka arritur fazat e krijimit , dizajnit dhe futjen e te dhënave themelore
Konkurs për shenjzimin e monumenteve turistike ne Prizren	Drejtoria ka përgatitur detyrat projektuese të projektit, dhe projekti tani është në fazën e procedurave te prokurimit.
Dizajnimi dhe shtypja e materialeve promovuese (Faza I)	Projekti: 7 arsye per ta vizituar Prizrenin broshura
Dizajnimi dhe shtypja e materialeve promoteuse Ribotim Katalogu”Vendtakim i Civilizimeve”	Ribotim i katalogut Vendtakim i Civilizimeve
Ndërtimi i shtigjeve te reja për biçiklistë	Projekti ne procedura te nënshkrimit te kontratës
Videospoti Prizreni ne 4 stine	Lënda ne procedura tenderuese-
Mirëmbajtja e muzeut arkeologjik te Lidhja e Prizrenit	Projekt në procedurë te prokurimit
Zhvillimi i turizmit urban	Projekti: Vera kulturore Ne pritje te vendimit nga Kryetari i Komunës
Zhvillimi i turizmit malor rural	Vendi për piknik – 15.000 euro
Zhvillimi i turizmit malor rural	Projekti:Cvileni si destinacion per Paraglinding
Zhvillimi i turizmit malor rural	Via Ferrata ne Gryken e Lumbardhit – Memorandum bashkëpunimi me SWISSCONTACT

DREJTORIA E EMERGJENCËS DHE SIGURISË

Drejtoria për Emergjencë dhe Siguri gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2019 me sukses i ka përfunduar disa prej projekteve të cilat janë paraparë në Planin e Punës në këtë periudhë, dhe disa janë në realizim e sipër sipas procedurave të prokurimit publik.

Nga investimet kapitale:

1. Hartimi i Planeve Emergjente (në procedurë),
2. Intervenimi për rastet Emergjente (në procedurë),
3. Blerja e një automjeti për zjarrfikës (në procedurë),
4. Vendosja e kamerave të qytetit (në procedurë),

Nga mallra dhe shërbime:

1. Blerja e uniformave për zjarrfikës profesional (e realizuar),
2. Planet e ushtrimeve dhe gatishmëria e zjarrfikësve lokalë (e realizuar),
3. Blerja e uniformave për zjarrfikës sezonal (e realizuar),
4. Servisimi i automjeteve të zjarrfikësve (në procedurë).

Nga subvencionet:

Janë subvencionuar 4 raste të cilat janë të prekura nga zjarret dhe nga vërshimet.

- Shërbimi i zjarrfikësve është i mobilizuar 24h dhe i pajisur me teknikë dhe mjete të tjera të domosdoshme. Ky sektor tani më është në fazën përfundimtare për rekrutimin edhe të 30 zjarrfikësve të rregullt profesional dhe me pajisje teknike për të mbuluar edhe 3 qendra tjera, të cilat Komuna i ka ndërtuar objektet, ku brenda vitit do të funksionalizohen, për t'iu ofruar qytetarëve më shumë siguri dhe shërbime.
- Komuna çdo vit rekruton nga 20 zjarrfikës sezonal për t'ju ofruar mbështetje zjarrfikësve profesional në terren nga muaji qershor deri në muajin shtator, tani më këta zjarrfikës janë duke krye punë si mbështetës. Ky shërbim ka realizuar një numër të madh intervenimesh të suksesshme, ku gjatë kësaj periudhe kanë ndërhyrë në gjithsej 292 raste, duke filluar nga ato më të shpeshta, për shuarjen e zjarreve, intervenime të tjera teknike (qofshin ato me rastin e aksidenteve në komunikacion, vërshime apo shqetësimeve tjera të natyrave të ndryshme të qytetarëve).
- Ngritja e nivelit të shpejtësisë reaguese ka ardhur si rezultat i disiplinës në punë, i trajnimeve të vazhdueshme të personelit, i furnizimit me automjete të reja dhe teknikë tjetër përcjellëse, si dhe përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës në Komunën e Prizrenit.
- Gjatë kësaj periudhe sektori i zjarrfikësve ka pasur disa ushtrime me KFOR-in dhe FSK-në në lëmin e kërkim- shpëtimit, në shkollën fillore në fshatin Vërmicë si dhe në liqenin e Vërmicës, në rastet e aksidenteve të ndryshme si dhe në ofrimin e intervenimeve gjatë paraqitjes së zjarreve dhe fatkeqësive natyrore të ndryshme.
- Gjatë kësaj periudhe të raportimit është shtuar numri i inspektimeve dhe dhënia e rekomandimeve adekuata me qëllim të respektimit të masave parandaluese nga zjarri dhe fatkeqësive tjera të mundshme, si: (mbushja me kohë e aparateve për shuarjen e zjarreve, shkallët emergjente në objektet publike dhe ato të rëndësisë së veçantë etj.). Pastaj, janë ndërmarrë edhe një sërë masash dhe aktiviteteve ku janë rekomanduar më qëllim të shtimit të masave së sigurisë, të cilat doemos duhet të respektohen, në bazë të ligjeve ekzistuese. Këtu duhet të përmendim edhe inspektimet e shumta që janë kryer lidhur me shkaktarët e paraqitjes së zjarreve, ku është kërkuar edhe mendimi dhe vlerësimi i inspektorëve tanë dhe bashkëpunimi i tyre me organet e policisë dhe hetuesisë.
- Në kuadër të DES gjithashtu veprojnë edhe inspektorët e parandalimit apo preventivës, të cilët zakonisht janë në terren, në bazë të Planit të Punës, për parandalimin dhe përcaktimin e kushteve sa më të mira për tejkalimin e fatkeqësive natyrore nga zjarri dhe fatkeqësive tjera që mund ta rrezikojnë jetën e qytetarëve.
- Në kuadër të ngritjes së nivelit të gatishmërisë, gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë këto veprime:
 - Raportime nga vendi i ngjarjes: 52 raste,
 - Hulumtime të zjarreve: 14 raste,
 - Pëlqime: 26 raste,
 - Inspektime të rregullta; 20 raste.

DES gjatë këtij viti ka rritë kapacitetin me mjete të ndryshme teknike, pastaj është furnizuar edhe Sektori i Zjarrfikësve me pajisje të nevojshme, më qëllim që personelit ti sigurohen kushte më të mira të punës, të cilat kanë qenë tejet të domosdoshme. Të gjitha këto mjete janë siguruar nga buxheti i Komunës.

Funksionimi i forumeve të sigurisë – Kryesues i këtij Këshilli është Kryetari i Komunës së Prizrenit Prof. dr. Mytaher Haskuka dhe Koordinator i Këshillit është Idaim Kryeziu. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ka gjithsej 33 anëtarë, ku sipas Planit të Punës janë planifikuar shumë aktivitetet lidhur me sigurinë publike. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën kohore janar - qershor ka mbajtur dy takime të rregullta ku njëri takim është e mbajtur në koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në këtë takim janë diskutuar tema të ndryshme si situata e sigurisë për periudhën mars - maj 2019, procesi i legalizimit të armëve, siguria në trafik etj, ndërkaq u dhanë edhe disa rekomandime Policisë së Kosovës dhe Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që të ndërmarrin masa për trajtimin dhe largimin e lypsarëve në qytetin e Prizrenit, të rritet përgjegjësia për heqjen nga rruga të qenve endacak.

Siguria në Komunën e Prizrenit vlerësohet se është e qetë dhe stabile.

DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

- Gjatë kësaj periudhe, DKRS ka pranuar mbi 250 kërkesa nga subjekte të ndryshme kulturore, rinore dhe sportive, të cilat kryesisht kërkojnë mbështetje materiale, sigurimin e transportit apo edhe sigurimin e hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive në Komunën e Prizrenit.
- DKRS, për vitin 2019 për investime kapitale ka pasur një buxhet prej 1.135.000 €, për subvencione, 180.000.00, kurse për mallra dhe shërbime 110.000.00 €.
- Janë vizituar objektet ku janë duke u zhvilluar punimet në realizimin e projekteve kapitale, sikurse që janë: Stadiumi i qytetit në Prizren, Stadiumi në Sërbicë, Shtëpia e Kulturës në Zhur, Stadiumi i në Zhur, Ndërtimi i terreni sportiv në Piranë, Medvec, Ndërtimi i shtegut të atletikës në Boka – Korishë, Ndërtimi terreneve sportive në Prizren, Ndërtimi i i Pishinës Olimpikë në Prizren etj.
- Është realizuar vendimit të Kryetarit të Komunës për subvencionimin e subjekteve kulturore, rinore e sportive të Komunës së Prizrenit. Me këto subjekte janë nënshkruar marrëveshjet e bashkëpunimit, pastaj janë përcjellë aktivitetet dhe realizimi i projekteve të subvencionuara. Krahas kësaj janë zhvilluar edhe takime pune me MKRS-në, lidhur me projektet të cilat kjo Ministri ka paraparë të investoj në Prizren gjatë vitit 2019. Janë zhvilluar takime pune me përfaqësuesit e fshatrave, janë evidentuar lokacionet dhe është punuar në nxjerrjen e dokumentacionit të nevojshëm për fillimin e punimeve në këto projekte.
- Në kuadër të shënimit të 11 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës janë mbajtur aktivitete të shumta si ato përkujtimore, ashtu edhe ato në Bibliotekën e qytetit, defile me fëmijë, koncerte, orë letrare, ekspozita e shfaqje teatrale.
- **Më 20.02.2019** është zhvilluar debat publik me qytetarë me temën; Propozim rregullorja për kategorizimin e klubeve sportive të Komunës së Prizrenit, ku morën pjesë një numër të madh të OJQ-ve, klubeve sportive dhe i të interesuarve, kryesisht nga fusha e sportit. Kjo rregullore u miratua në mbledhjen e Kuvendit Komunal më datën 29.03.2019.
- **Më 07.03.2019** Këshilli Drejtues i Teatrit Profesionist “Bekim Fehmiu” të Prizrenit ka raportuar lidhur me takimin e mbajtur që kanë të bëjnë me punën dhe vështirësitë e Teatrit Profesionist të Prizrenit.
- **Më 22.04.2019** në organizim të DKRS-së është shënuar me aktivitet kulturoro-sportiv “Dita Ndërkombëtare e Tokës”.
- **Më 26.04.2019** është shpallur lista përfundimtare e përfituesve të subvencioneve për vitin 2019 nga lëmitë e kulturës, rinisë dhe sportit.
- **Më 29.04.2019** është hapur tenderi për organizimin e festivalit tradicional “Zambaku i Prizrenit”.
- **Më 30.04.2019** janë përruruar terrenet sportive në hapësirat e qendrës sportive dhe paisjet e fitnesit për rekreacion në Marash.
- **Më 10 - 12.06.2019** me aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive është shënuar dita e çlirimit të qytetit të Prizrenit. Janë mbajtur koncerte dhe turne në futboll dhe në basketboll për nder të ditës së çlirimit të qytetit të Prizrenit

- **Më 12.06.2019** në qendrën sportive “Sezair Surroi” është bërë inaugurimi i tribunave lëvizëse të cilët do të shërbejnë në ngritjen e kapacitetit të shikuesve gjatë ndeshjeve që do të zhvillohen në këtë palestër.
- **Më 26.06.2019** DKRS në bashkëpunim me Kuvendin Komunal të Prizrenit kemi furnizuar me 2843 libra me tituj të ndryshëm Bibliotekën Ndërkomunale të qytetit.
- **Me datë 29.06.2019** në Kino Lumbardhi është organizuar edicioni i 30-të i festivalit të këngës së lehtë qytetare “Zambaku i Prizrenit”, artistët pjesëmarrës në këtë festival kanë qenë nga Kosova dhe Shqipëria.

DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE

Investime Kapitale

1. Programi i ndërtimit dhe Meremetimit

Në muajin janar është shpallur njoftimi për aplikim në 3 programet e banimit që DPMS ka për 2019 dhe ka qëndruar i hapur deri në fund të muajit Mars. Në këto programe kanë aplikuar gjithsej 446 aplikues. Gjatë muajve prill-qershor është formuar komisioni për verifikimin dhe vlerësimin familjeve që kanë aplikuar në fillim të qershorit komisioni i poentimit duke u bazuar në pyetësorin e plotësuar dhe nënshkruar nga vetë aplikuesit ka kryer poentimin për secilin aplikues dhe ka përgaditur listën preliminare e cila pas shpalljes dhe pritjes së ankesave të mundshme, u definua si përfundimtare dhe u njoftua me qytetarët.

Nga programi i ndërtimit të shtëpive kanë përfiturar 59 familje, nga ai meremetimit të shtëpive 31 familje dhe ai i meremetimit të kulmit 40 familje.

Gjatë kësaj periudhe Kryetari i Komunës ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me shoqatën bamirëse Jetimat e Ballkanit për ndërtimin e 30 shtëpive sipas formës çelësat në dorë. Për këtë qëllim Komuna do të participojë me nga 5000 euro dhe pjesën tjetër do e mbulojë shoqata dhe kështu familjet skamnore fitojnë një strehim të mirë dhe të sigurt.

Objekti- Shtëpia me bazë në kumunitet-Dardania II

Me fillimin e sezonës së ndërtimit ka filluar të ndërtohet objekti për persona me aftësi të kufizuara në lagjen Dardania, sipas kontratës dhe marrëveshjes së realizuar me MPMS nga viti 2018 dhe e cila është ripërtërirë në fillim të vitit 2019. Aty punimet janë në përfundim e siper dhe së shpejti pritet që kompania të ta dorëzojë objektin.

Muri mbrojtës

Gjatë kësaj periudhe kohore është marrur Vendimi dhe është zhvilluar faza tenderuse për ndërtimin e një muri 40 m gjatës te Shtëpia me bazë në komunitet në Dardania II me qëllim të rrafshimit të oborrit dhe sigurimit të hapsires së rrafshtë për parking dhe hapsir të gjelbërt për këtë object. Tashmë operatori që ka fituar është duke i kryer punimet dhe gjithqka po shkon sipas projektit.

Banesat sociale Petrovë

Në lagjen Petrova është pothuajse në përfundim Llamella III –për të cilën janë të zgjedhura familjet dhe është duke u ndërtuar edhe Llamella e IV e cila pritet të jetë gati në pjesën e dytë të këtij viti dhe që sipas konkursit që do të shpallet do të përzgjidhen 30 familje. është

Subvencione

Shpenzimet e Varrimit

Gjatë kësaj periudhe menjëherë pas marrjes së mjeteve të mbetura që e ka bërë Asambleja Komunale DPMS-së i janë krijuar mundësitë për shlyerjen e borgjit për 510 familje –si borgj i vitit 2018 , ndërkohë DPMS nga planifikimet për këtë vitë ka paguar për rreth 80 familje për shpenzime të varrimit dhe është në procedurë e sipër që të paguajë edhe pjesë tjera sipas alokimit të mjeteve që bëhen.

Gjatë kësaj kohe DPMS ka bërë thirrje për përkrahje të projekteve të OJQ-ve që ofrojnë shërbime në sferën e mirëqenjes dhe për këtë qëllim ka ndarë Shumen 26100 euro për 11 OJQ që janë vlersuar nga komisioni i krijuar me Vendim nga Kryetari i Komunës.

Mallra dhe shërbime

Sa i përket kësaj kategorije vlen të theksohet se janë proceduar dhe kryer gjitha ato shërbime që i përkasin kësaj kategorije të shpenzimeve.

Aktivitetet tjera të DPMS

Ndërkohë vlen të theksohet se DPMS ka bërë verifikimin e emrave në listen për ndërtimin e shtëpiave sipas marrëveshjes me MPMS dhe tashmë lista është dorzuar dhe MPMS vazhdon me procedurat tjera sipas marrëveshjes. Në atë listë do të përfitojnë ndërtim shtëpije 92 familje të komuniteteve pakica në Prizren.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Kërkesat e pranuar	Kërkesat e vendosura									
	njoftimet	Të miratuara	Deklarata, vërtetim, akt-përcjellëse, propozime kërkesat e ndryshme dhe shkresa të ndryshme	Të refuzuara	Të hedhura poshtë	Procedura është pezulluar	Lëndët në procedurë	Ekstrat për Prevallë	Qasje ne doku. zyrtar	Ankesat e dërguara në MMPH
Lëndet e pranuar për periudhën – 01.01.2019- 30.06.2019										
966	121	280	170	84	9	11	254	30	2	5

Qëllimet	Objektivat/ Projektet	Aktivitetet
Implementimi i Planeve Rregullative	Vazhdimi i projektit për hapjen e rrugëve	Me qëllim të implementimit të Planeve Rregullative Urbane DUPH-ja vazhdon me projektin për hapjen e rrugëve aty ku ka Plane rregullative.
Hartimi i hartave zonale	Për hartimin e hartave Zonale së pari duhet të vlersohet PZHK-ja sipas Udhëzimit Administrativ. Vlersimi i PZHK ka përfunduar dhe është dorzuar MMPH . Prandaj po vazhdojm me procedurat e hartimit të hartave zonale.	DUPH bashkë me projektantin dhe Drejtoritë tjera Komunale dhe ekspertet e jashtëm kemi mbajtur takime të shumta . Ne si drejtori jemi në kontakt me projektantin .Do të vazhdojm me takime deri sa të pregaditet projekti për diskutim publik.

Drejtoria e Kadastrës dhe Gjeodezisë

Raporti 03.01.2019 – 30.06.2019

		Pranuar	Të kryera	Të pa kryera (Në procedurë)
1	Bartje (Blerje, Trashëgimi, Dhuratë, korigjimet, Hipoteka, dhe lëndë zyrtare)	2054	1682	372
2	Ndarje (copëtim, bashkim, rregullimi i mexhëve dhe kordinata)	1110	688	422
3	Lista poseduse	3181	3181	/
4	Kopje të planit	454	454	/
5	Certifikatë per social	986	986	/

Përfundim

Ky raport gjashtëmujor paraqet synimet në qeversije, prioritetet dhe aktivitetet kryesore të Komunës së Prizrenit për 6 mujorin e parë të vitit 2019 dhe të arriturat gjatë kësaj periudheje. Këtu përfshihen angazhimet e kryetarit, zyrave të tij dhe të gjitha drejtorive komunale.

Komuna e Prizrenit do të vazhdojë angazhimin edhe gjatë 6 mujorit të dytë, sipas planit të planifikuar për vitin 2019.

Kryetari i Komunës së Prizrenit

Mytaher Haskuka